



REPUBLIKA E KOSOVËS
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**

UDHËZUES

I PËRGJITHSHËM I MASHTI



PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT
MËSIMOR **NË VITIN SHKOLLOR
2021/2022** NË KUSHTE TË
PANDEMISË **COVID-19**



Mbështetur nga zyra e
UNICEF-it në Kosovë



REPUBLIKA E KOSOVËS
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**

UDHËZUES I PËRGJITHSHËM I MASHTI

PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT MËSIMOR NË VITIN
SHKOLLOR 2021/2022 NË KUSHTE TË PANDEMISË COVID-19

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| SHKURTESAT | 5 |
| PËRKUFIZIMET | 6 |
| 1. HYRJE | 7 |
| 1.1 SKENARI PËR RIKTHIM NË IEAA ME PRANI FIZIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2021/2022 | 9 |
| 1.2 QËLLIMI | 9 |
| 1.3 PARIMET E UDHËZUESIT | 10 |
| 2. PËRGJEGJËSITË..... | 12 |
| 2.1 TASK FORCAT | 12 |
| 2.2 DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PJESËMARRËSVE NË PROCESIN EDUKATIV-ARSIMOR..... | 14 |
| 3. SKENARËT | 18 |
| 3.1 INFOGRAFI | 21 |
| 4. PROCESI EDUKATIV PËR FËMIJËT PARASHKOLLOR | 23 |
| 5. PROCESI MËSIMOR PËR KLASAT 0-12 | 30 |
| 6.ZBATIMI I KURRIKULËS DHE UDHËZIMET METODOLOGJIKE | 41 |
| 7. MONITORIMI DHE INSPEKTIMI | 43 |
| 8. TRAJNIMI I MËSIMDHËNËSVE, PERSONELIT MENAXHERIAL DHE PËRKRAHËS TË IEAA DHE AKTERËVE TË TJERË..... | 44 |
| 9. ANEKSET | 45 |

Ky udhëzues është rishikim i udhëzuesit të mësimin në kushte të pandemisë COVID-19 të vitit paraprak 2020/21. Udhëzuesi u përditësua nga grupi punues i përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), përfaqësuesit e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) dhe Këshillit të Prindërve (KP), me mbështetje të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF).

SHKURTESAT

| | |
|---------------|---|
| BB | Banka Botërore |
| DKA | Drejtoritë Komunale të Arsimit |
| CDC | Centers for Disease Control and Prevention |
| IAAP | Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional |
| IEAA | Institucion Edukativ-Arsimor dhe Aftësues |
| IKSHPK | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës |
| IP | Institucion Parashkollor |
| KKK | Korniza Kurrikulare e Kosovës |
| KP | Këshilli i Prindërve |
| MASHTI | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| OBSH | Organizata Ndërkombëtare e Shëndetësisë |
| PIA | Plani Individual i Arsimit |
| RNF | Rezultatet e të nxënit të fushës të caktuara |
| RNL | Rezultatet e të nxënit të lëndëve të caktuara |
| SBASHK | Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë |
| SHSKUK | Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës |
| TF | Task Forcë |
| UNICEF | United Nations Children's Fund |
| UNESCO | United Nations Educational, Scientific, and Cultural Organization |

PËRKUFIZIMET

COVID-19¹: Infektimi me SARS-CoV-2, virusin që shkakton COVID-19, mund të shkaktojë sëmundje të formës më të lehtë ose të rëndë që në disa raste mund të jetë edhe fatale. Simptomat zakonisht përfshijnë ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje. Sëmundja mund të manifestohet me simptoma të tjera si ato të infektimit gastrointestinal. Po ashtu, personi mund të jetë asimptomatik megjithëse i infektuar me COVID-19. Sipas OBSH dhe CDC, simptomat e COVID-19 mund të shfaqen prej 2 deri në 14 ditë pas ekspozimit.

COVID-19 - Varianti Delta: Provat e reja tregojnë se rreziku i infektimit të sërishëm me SARS-CoV-2 është më i madh me variantin Delta në krahasim me variantin Alpha. Delta është dyfish më infektues se sa lloji fillestar COVID-19 dhe rreth 50% më infektues se sa variantet e tjera shqetësuese të cilat janë zbuluar.

Infektimi²: infektimi mund të përhapet prej një personi në tjetrin përmes:

- **Kontaktit të ngushtë** në mes të personave. Kontakt i ngushtë është personi që³:
 - Ka pasur kontakt ballë për ballë me rastin e konfirmuar COVID-19 në distancë prej 1 metër;
 - Ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë të pambrojtur me sekrecione infektive nga një rast i konfirmuar COVID-19;
 - Ka udhëtuar së bashku me një rast të konfirmuar COVID-19 për më shumë se 15 minuta duke përdorur mënyra të ndryshme të transportit;
- Përmes spërklave kur një person i infektuar kollitet ose teshtin;
- Me prekje të hundës, gojës ose syve pasi ta ketë prekur një sipërfaqe ose objekt të kontaminuar me SARS-CoV-2;
- **Infektimi me variantin Delta:** Paraqet rrezik më të madh që personat e prekur të zhvillojnë simptoma të cilat kërkojnë hospitalizim.

Vaksinimi: Sipas të dhënave aktuale, vaksinat e miratuara nga OBSH dhe organet e tjera kompetente që janë në dispozicion, kanë efekt mbrojtës ndaj varianteve të COVID-19. Megjithatë, asnjë vaksinë nuk është 100% efektive, që do të thotë se edhe personat e vaksinuar mund të infektohen dhe të infektojnë persona të tjerë.

Testimi: IKSHPK do të realizojë teste të kohëpaskohshme për përcjelljen e situatës epidemiologjike në IEAA. Po ashtu, pjesëtarët e personelit të IEAA që nuk janë vaksinuar, në përputhje me Vendimet në fuqi, mund të obligohen të paraqesin dëshmi të testit negativ.

1 <https://niph-rks.org/wp-content/uploads/2020/05/UDHEZUES-I-PERKOHSEM-APLIKIMI-I-MASAVE-COVID-19-INSTITUCIONET-PUB-LIKE-E-PRIVATE.pdf>

2 <https://niph-rks.org/wp-content/uploads/2020/05/UDHEZUES-I-PERKOHSEM-APLIKIMI-I-MASAVE-COVID-19-INSTITUCIONET-PUB-LIKE-E-PRIVATE.pdf>

3 <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/COVID-19-in-children-and-the-role-of-school-settings-in-transmission-second-update.pdf>

1. HYRJE

Humbja e mësimimit në vitin shkollor 2019/20 si rezultat i mbylljes së shkollave për shkak të pandemisë së COVID-19 parashikohet të ketë ndikim afatgjatë në edukimin, arsimimin dhe të ardhmen e fëmijëve/nxënësve. Vetëm për periudhën mars-qershor 2020, vlerësohet se humbja mësimore në vendet e Ballkanit Perëndimor ka qenë rreth 9 pikë të PISA (apo 25% të vitit shkollor) për nxënësit që kanë mbajtur mësim në distancë, ndërsa pothuajse dyfish më e madhe ka qenë humbja mësimore për nxënësit që nuk kanë mbajtur mësim në distancë fare (përkatesisht, rreth 16 pikë të PISA apo 40% të vitit shkollor)⁴. Organizatat botërore si UNICEF, UNESCO, OBSH, Banka Botërore dhe organizata të tjera, gjithnjë e më shumë theksojnë se çdo formë e organizimit të mësimimit, përveç formës me orar të plotë dhe me prani fizike në shkollë, pritet të rezultojë me ulje të mëtejme të cilësisë në arsim.

Mbyllja e shkollave ka ndikuar negativisht në aspektin social e emocional dhe ka rënduar përgjithësisht shëndetin mendor të fëmijëve dhe të rinjve. Hulumtimet tregojnë se ka rritje të rasteve të ankthit, depresionit, dhe vetëlëndimit tek fëmijët e moshës shkollore⁵ dhe rrjedhimisht, edhe rritje të braktisjes së shkollës⁶. Gjithashtu, ka pasur reduktim të aktiviteteve fizike, rritje të ushqyeshmërisë jo të shëndetshme, rritje të kohës së kaluar para ekranit.⁷⁸

Me reduktimin e pranisë fizike në shkolla janë zvogëluar edhe mundësitë e raportimit dhe identifikimit të fëmijëve dhe të rinjve të abuzuar apo në rrezik për abuzim.

Infektimi me virusin SARS-CoV-2 është shumë më i vogël tek fëmijët dhe zakonisht ata kanë simptoma më të lehta që ka rezultuar me një numër relativisht të vogël të hospitalizimeve⁹. Bazuar në këto prova, organizatat ndërkombëtare si UNICEF dhe OBSH¹⁰ tashmë kanë bërë thirrje që fëmijët të kthehen në shkolla dhe kanë iniciuar rimëkëmbjen e procesit arsimor në nivel global. Rimëkëmbja parasheh rikthimin me prani fizike në IEAA si hapin më të rëndësishëm që mund të ndërmerret për zvogëlimin e pabarazive të krijuara dhe për t'u dhënë qasje nxënësve në edukim cilësor dhe gjithpërfshirës.

Hapja e IEAA është hap thelbësor për të gjitha vendet e botës. Dr. Hans Henri P. Kluge, drejtor rajonal i OBSH-së për Evropë thekson se “pandemia ka shkaktuar ndërprerjen më katastrofale në historinë e arsimit”. Për këtë arsye, sipas tij, është esenciale që kthimi në klasë/shkollë të ndodhë sa më shpejt dhe pa ndërprerje¹¹. Për të siguruar kthimin në klasa dhe rimëkëmbjen

4 <https://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590682058272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf>

5 <https://www.who.int/westernpacific/news/commentaries/detail-hq/school-reopening-can-t-wait>

6 <https://www.unicef.org/eca/reports/building-resilient-education-systems-beyond-COVID-19-pandemic-second-set-considerations>

7 <https://bmjpaedsopen.bmj.com/content/5/1/e001043>

8 <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/342075/WHO-EURO-2021-2151-41906-59077-eng.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

9 <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/COVID-19-in-children-and-the-role-of-school-settings-in-transmission-second-update.pdf>

10 <https://www.who.int/westernpacific/news/commentaries/detail-hq/school-reopening-can-t-wait>

11 <https://www.unicef.org/press-releases/all-schools-europe-central-asia-should-remain-open-and-made-safer-COVID-19-say-who>

e arsimit duhet të ndërmerren vazhdimisht hapa kritikë, siç janë: ofrimi i vaksinave për gjithë personelin e IEAA deri sa të gjithë të jenë të vaksinuar, organizimi i fushatave vetëdijësuese për rëndësinë e vaksinimit; ofrimi i vaksinave për fëmijët e moshës 12 vjeç e më shumë që kanë sëmundje përcjellëse dhe kanë rrezikshmëri të lartë ndaj COVID-19.

Hapa të tjerë thelbësor janë edhe përmirësimi i vazhdueshëm i ambientit të IEAA përmes përmirësimit të ventilimit/ajrosjes; sigurimit të ujit; sigurimit të mjeteve dezinfektuese për duar dhe hapësira; zvogëlimit të madhësisë së grupeve, aty ku mundësitë fizike e pamundësojnë mbajtjen e rekomanduar të distancës; fuqizimi i respektimit të masave si mbajtja e maskës; larja e duarve; mbajtja e distancës gjatë gjithë kohës, sidomos gjatë qëndrimit në ambiente të mbyllura; dhe testimi i rregullt i fëmijëve dhe personelit të IEAA. Ndonëse pjesa e konsiderueshme e mësimitdhënësve/edukatorëve dhe personelit tjetër të IEAA tashmë janë vaksinuar, vaksinimi dhe respektimi i masave të përcaktuara në protokollin COVID-19 duhet të vazhdojë.

COVID-19 tek fëmijët dhe roli i mjediseve të IEAA në transmetim¹²

Në të gjitha grupmoshat është raportuar rritje e transmetueshmërisë së të gjitha varianteve të SARS-CoV-2, më së shumti të variantit Delta. Në rajonet ku përqindja e të rriturve plotësisht të vaksinuar kundër COVID-19 është e lartë, por ku fëmijët nuk vaksinohen, mund të parashikohet që në muajt e ardhshëm të ketë gjithnjë e më shumë raste të raportuara të SARS-CoV-2 në mesin e fëmijëve.

Fëmijët e të gjitha moshave janë të ndjeshëm ndaj SARS-CoV-2 dhe mund ta bartin atë tek të tjerët. Fëmijët e vegjël me SARS-CoV-2 janë më pak bartës të virusit tek të tjerët sesa fëmijët më të mëdhenj dhe të rriturit.

Duke pasur parasysh rrezikun e vazhdueshëm nga mundësia e bartjes së virusit midis fëmijëve të pavaksinuar, është e domosdoshme që IEAA të kenë nivel të lartë të gatishmërisë për vitin shkollor 2021/2022. Masat duhet të përshtaten me nivelet e bartjes së SARS-CoV-2 në komunitet, si dhe me mjedisin arsimor dhe grupmoshën përkatëse. Zbatimi i masave duhet të bëhet ashtu që fëmijëve t'u sigurohet mjedis optimal mësimor dhe shoqëror, duke e zvogëluar njëkohësisht edhe rrezikun e bartjes.

IEAA duhet të jenë vigjilente ndaj mundësisë së paraqitjes së rasteve të reja me SARS-CoV-2, në mënyrë që të reagojnë në kohë dhe të ndërmarrin veprime të duhura sipas protokollit COVID-19.

Situata epidemiologjike me COVID-19 në Kosovë¹³

Situata epidemiologjike me COVID-19 në Kosovë ka shënuar rritje eksponenciale të numrit të rasteve nga 3,513 në 23,174 raste brenda dy javëve (11 – 24 gusht 2021). Rastet e vdekjeve të raportuara nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) dhe spitalet COVID-19 janë rritur nga 9 në 96 raste të vdekjes.


Në mesin e numrit të përgjithshëm të të prekurve me COVID-19, grupmosha më e prekur është 30-39 vjeç, me 18.9%. Gjithashtu vërehet rritje e rasteve në grupmoshat 10-19 (0.4%) dhe 20-29 vjeç (0.6%). Shih grafikonin:

¹² <https://www.ecdc.europa.eu/en/publications-data/children-and-school-settings-COVID-19-transmission>

¹³ Analizë e situatës epidemiologjike me COVID-19, 26 gusht 2021, IKSHPK

Vaksinohuni për ta mbrojtur veten dhe të tjerët!

Përqindja e të prekurve me COVID-19 sipas grupmoshave¹⁴



1.1 SKENARI PËR RIKTHIM NË IEAA ME PRANI FIZIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2021/2022

Në linjë me strategjitë e rikthimit në shkollë të shumë shteteve në botë, MASHTI ka hartuar Skenarin e Rikthimit në IEAA me prani fizike dhe orar të plotë mësimor, pasi që kjo formë e organizimit të procesit mësimor është më e përshtatshme dhe dobiprurëse për arsimimin dhe mirëqenien e nxënësve në përgjithësi. Skenari i Rikthimit është paraparë si skenar shtesë i skenarëve ekzistues A, B, C¹⁵, të cilët janë zbatuar në vitin shkollor 2020/21 dhe ende mbesin në fuqi. Skenari i Rikthimit, sikurse skenarët e tjerë, parasheh që të gjitha masat e rekomanduara nga IKSHPK dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH) të përcillen me kujdes.

Zbatimi i skenarëve Rikthimi, A, B, apo C, do të varet nga situata epidemiologjike në IEAA. Përgjegjëse për përcaktimin e skenarit që do të zbatohet në shkolla dhe komuna është Task Forca në nivel të institucionit në bashkëveprim me Task Forcën e Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), në përputhshmëri me rekomandimet e IKSHPK. Skenarët gjegjësis që zbatohen duhet të reflektojnë ndjeshmërinë e situatës aktuale, duke marrë parasysh kujdesin për shëndetin e fëmijëve dhe personelin e IEAA, si dhe ruajtjen e shëndetit publik në përgjithësi.

1.2 QËLLIMI

Organizimi i procesit mësimor për vitin shkollor 2021/2022 sipas skenarëve Rikthimi, A, B apo C, bëhet me qëllim të rikthimit në normalitet duke marrë në konsideratë shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve/nxënësve dhe personelit edukativ-arsimor dhe teknik. Organizimi i procesit mësimor sipas skenarëve është fleksibil dhe mundëson përshtatjen me kushtet epidemiologjike.

¹⁴ Analizë e situatës epidemiologjike me COVID-19 për periudhën 11-24 gusht, 26 gusht 2021, IKSHPK

¹⁵ https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezuesi-final-file-10-09-2020_1.pdf

1.3 PARIMET E UDHËZUESIT

Udhëzuesi 2021/2022 udhëhiqet nga parimet themelore si më poshtë, që lidhen me të drejtat e secilit fëmijë/nxënës që pa marrë parasysh gjendjen ekonomike, gjininë, përkatësinë etnike, gjuhën, apo aftësitë e kufizuara, të përfshihet në edukim/arsim dhe të përfitojë maksimalisht bazuar në nevojat individuale të tij/saj.

Qasja në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës: Situata aktuale ka thelluar edhe me shumë pabarazitë në mes të fëmijëve, andaj parësore është krijimi i mundësive të barabarta për t'i trajtuar dallimet e fëmijëve/nxënësve në procesin e mësimnxënies dhenevojat e tyre të veçanta. Gjatë realizimit të procesit edukativ-arsimor, edukatorët/mësimdhënësit duhet të jenë gjithëpërfshirës, fleksibil dhe të përdorin forma të përshtatshme të punës për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta, për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, për fëmijët që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, për fëmijët që kanë mungesë të qasjes në teknologji të nevojshme për të mësuar në distancë (p.sh., Internet të shpejtë ose kompjuter në shtëpi).

Mirëqenia e fëmijëve/nxënësve (shëndeti mendor dhe përkrahja psiko-sociale): Në kushte të pandemisë COVID-19 qëllimi kryesor i edukimit dhe arsimit duhet të jetë mirëqenia e fëmijëve/nxënësve. Puna e mësimdhënësve duhet të përqendrohet në mbështetjen e fëmijëve për të nxënë. Nëse edukatorët/mësimdhënësit janë mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm ndaj fëmijëve/nxënësve, atëherë do të shmangen efektet negative psikologjike që mund të shkaktojë pandemia tek ata.

IEAA të sigurtat për të gjithë fëmijët dhe adoleshentët: Duke pasur parasysh përhapjen e shpejtë të infektimit me COVID-19 në mes të nxënësve dhe mësimdhënësve, IEAA duhet të sigurojnë nyje sanitare dhe ujë të rrjedhshëm si dhe pajisje mbrojtëse dhe praktika të higjienës personale. Për këtë nevojitet një bashkëpunim i ngushtë me prindërit dhe pjesëmarrje aktive e tyre në procesin e planifikimit në nivel të institucionit.

Zhvillimi i kompetencave: Gjatë realizimit të procesit mësimor, në rrethana pandemie, duhet të merren për bazë kompetencat që duhet të arrijë secili fëmijë/nxënës e të cilat janë të përcaktuara në Standardet e Zhvillimit për Fëmijëri të Hershme dhe Kornizën e Kurrikulës të Kosovës (KKK). Kjo nënkupton që mësimdhënësit duhet të jenë të kujdesshëm në modifikimin, realizimin e përmbajtjeve lëndore përmes përdorimit të metodave dhe teknikave të ndryshme të mësimdhënies, të cilat duhet të jenë në përputhje me moshën e fëmijëve/nxënësve, por edhe t'i përshtaten përmbajtjes, kushteve dhe rrethanave aktuale.

Autonomia dhe fleksibiliteti: Me KKK rregullohen qartë normat e autonomisë dhe të fleksibilitetit në nivel shkolle. Kjo ka të bëjë me mundësinë dhe përgjegjësinë e personelit të IEAA për hartimin e planit vjetor të punës dhe shfrytëzimin fleksibil të kohës mësimore duke mundësuar organizimin e orëve mësimore sipas kërkesave të përcaktuara me KKK për fusha kurrikulare, respektivisht lëndë mësimore si planifikimin e orëve të mësimi plotësues, orëve shtesë, planifikimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare e formave të mësimdhënies interaktive, mjeteve mësimore dhe çështjeve të tjera në kontekstin e mësimdhënies dhe nxënies së tërësishme si dhe zhvillimit të kompetencave.

2

PËRGJEGJËSITË



2. PËRGJEGJËSITË

Me qëllim të organizimit sa më efikas të procesit edukativ-mësimor me prani fizike në kushte të pandemisë, në vitin e ri shkollor 2021/2022 do të vazhdojë funksionimi i tri Task Forcave në nivel të MASHTI, DKA dhe IEAA, sipas përgjegjëseve të përcaktuara si në vijim.

2.1 TASK FORCAT

Secili IEAA duhet ta mbajë aktive Task Forcën (TF) e vet, e cila bashkëvepron me TF në DKA dhe i raporton asaj. TF në DKA komunikon në mënyrë të rregullt me TF në MASHTI për aplikimin e skenarëve dhe MASHTI ofron mbështetje në bazë të kompetencave të parapara sipas udhëzuesit.

TASK FORCA NË NIVEL TË MASHTI

PËRBËRJA E TASK FORCËS NË NIVEL TË MASHTI:

1. Përfaqësuesi/ja nga Kabineti i Ministres
2. Drejtori/e i/e Departamentit të Arsimit Parauniversitar
3. Drejtori/e i/e Departamentit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional
4. Drejtori/e i/e Inspektoratit të Arsimit
5. Koordinator/i ja për shkollat promovuese të shëndetit
6. Kryesuesi/ja i/e Kolegjiumit të DKA-ve
7. Përfaqësuesi/ja nga IKSHPK
8. Përfaqësuesi/ja nga Këshilli i Prindërve dhe Nxënësve
9. Përfaqësuesi/ja nga SBASHK
10. Përfaqësuesi/ja nga UNICEF
11. Përfaqësuesi/ja nga OBSH

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

- Mban mbledhje të rregullta për vlerësim të situatës (së paku një herë në muaj) dhe jep rekomandime për Ministren për veprime të mëtutjeshme;
- Harton raporte të rregullta për Ministren;
- Monitoron zbatimin e skenarëve në vitin e ri shkollor 2021/22;
- Monitoron zbatimin e masave në nivel të IEAA të përcaktuara në protokollin e COVID-19;
- Mban takime të rregullta me të gjitha palët e tjera në kuadër të përgjegjëseve të tyre.

TASK FORCA NË NIVEL TË DKA

PËRBËRJA E TASK FORCËS NË NIVEL TË DKA:

1. Drejtori/e i/e DKA
2. Drejtori/e i/e Financave
3. Drejtori/e i/e Mirëqenies Sociale
4. Drejtori/e i/e Shëndetësisë
5. Inspektori/ja Sanitar/e
6. Përfaqësuesi/ja i/e drejtorëve të institucioneve arsimore
7. Përfaqësuesi/ja i/e drejtorëve të institucioneve parashkollore

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

- Mban mbledhje të rregullta për vlerësim të situatës në nivel të komunës (së paku një herë në muaj);
- Harton raporte të rregullta për Task Forcën në MASHTI;
- Monitoron zbatimin e skenarëve në nivel të komunës;
- Analizon raportet nga secila Task Forcë në IEAA;
- Monitoron zbatimin e masave në nivel të IEAA të përcaktuara në protokollin e COVID-19;
- Përpilon plan të zëvendësimit të pjesëtarëve të personelit që mungojnë në bashkëveprim me Task Forcën në IEAA.

TASK FORCA NË NIVEL TË IEAA

PËRBËRJA E TASK FORCËS NË NIVEL TË IEAA:

1. Kryetari /ja i/e Këshillit Drejtues
2. Drejtori/e i/e shkollës/Institucionit parashkollor
3. Kryetari/ja i/e Këshillit të Mësimdhënësve
4. Kryetari/ja i/e Këshillit të Prindërve
5. Kryetari/ja i/e Këshillit të Nxënësve
6. Koordinator/ja për Teknologji
7. Koordinator/ja për Cilësi (aty ku ka)

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

- Përpilon plan të punës (ku përfshihen: mbledhjet e rregullta, orari, formati i takimeve, mënyra e vendimmarrjes);
- Përpilon plan të veprimit dhe vendos mbi aplikimin e skenarëve varësisht nga gjendja në IEAA/klasë;
- Monitoron zbatimin e skenarëve në IEAA/klasa;
- Verifikon skenarët me nivelin e rrezikshmërisë në komunë dhe kushtet e IEAA në bashkëveprim me Task Forcën në DKA;
- Përcakton masat përkrahëse për edukatorët/mësimdhënësit, fëmijët/nxënësit, prindërit dhe personelit tjetër të IEAA;
- Raporton tek Task Forca e DKA-së (mbi mungesat e nxënësve dhe punonjësve përkatës; situatën në IEAA; mungesën/nevojën për materiale higjienike, edukative etj.);
- Evidenton nevojat e mësimdhënësve/edukatorëve për trajnim;
- Përpilon plan të zëvendësimit të pjesëtarëve të personelit që mungojnë;
- TF në IEAA kanë përgjegjësi t'i organizojnë klasat varësisht nga numri i nxënësve dhe hapësirës që kanë në dispozicion dhe në bashkëveprim me TF në DKA.

* TF e IEAA private raportojnë tek divizioni për Sigurimin e Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim në MASHTI.

2.2 DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PJESËMARRËSVE NË PROCESIN EDUKATIV-ARSIMOR

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT (MASHTI)

- Mban Task Forcën e MASHTI operacionale;
- Formulon dhe miraton skenarët sipas nivelit të rrezikshmërisë në bashkëpunim me IKSH-PK;
- Mbështet dhe komunikon në mënyrë të rregullt me DKA-të për zbatimin e skenarëve;
- Bashkëvepron me MSH, IKSHPK, DKA-të, IEAA dhe partnerët strategjikë për vetëdijësimin e komunitetit shkollor e të prindërve mbi rëndësinë e vaksinimit dhe respektimit të plotë të masave;
- Miraton tekstet dhe materialet mësimore dhe pajisë shkollat me tekste shkollore fizike dhe digjitale;
- Bashkëvepron me DKA për plotësimin e kushteve për organizimin e procesit edukativ-arsimor;
- Mban takime të rregullta me drejtorët e DKA-ve;
- Inspekton zbatimin e procesit edukativ-arsimor sipas skenarëve;
- Angazhon ekspertizë për çështje të veçanta apo hulumtime profesionale;
- Miraton Kalendarin e vitit shkollor 2021/2022;
- Ofron mbështetje për mësimdhënien dhe vlerësimin e fëmijëve/nxënësve për të arritur rezultatet e të nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave të Kurrikulës.

DREJTORITË KOMUNALE TË ARSIMIT (DKA-të)

- Mbajnë Task Forcat në nivel DKA operacionale;
- Koordinojnë dhe menaxhojnë IEAA dhe personelin arsimor në nivel të komunave dhe ndihmojnë në realizimin e mësimin sipas skenarëve;
- Vendosin format e vendimmarrjes, raportimit dhe vlerësimit të performancës së personelit përmes komunikimit fizik sipas protokollit COVID-19 apo komunikimit nëpërmjet formave të aprovuara virtuale, kur paraqitet kjo nevojë;
- Realizojnë aktivitete vetëdijësimi mbi rëndësinë e vaksinimit të komunitetit shkollor e prindërve për mbarëvajtjen e procesit mësimor si dhe shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve e të gjithë të tjerëve;
- Organizojnë trajnime për mësimdhënësit në nivel të komunës në bashkëpunim me MASH-TI dhe donatorët;
- Organizojnë takime individuale me drejtorë të IEAA;
- Raportojnë në baza javore në MASHTI për ecurinë dhe sfidat e organizimit të procesit mësimor si dhe për nivelin e vaksinimit të personelit shkollor në nivel të komunës;
- Komunikojnë në mënyrë efikase dhe të sigurt me Këshillin e Prindërve;
- Planifikojnë sigurimin dhe shpërndarjen e materialëve shkollorë të nxënësve;
- Evidentojnë fëmijët/nxënësit dhe edukatorët/mësimdhënësit që kanë nevojë për pajisje si laptopë dhe tabletë;
- Sigurojnë pajisje të nevojshme teknologjike për mësimin në distancë (me ndihmën e MASHTI ose të donatorëve);
- Ofron trajnime për ngritje të kapaciteteve për edukatorët/mësimdhënësit;
- Sigurojnë kushte për realizimin e procesit mësimor sipas skenarëve të përcaktuar në këtë udhëzues (Internet të qëndrueshëm; personel mbështetës teknik si pikë kontakti për IEAA për çështje të digjitalizimit).

INSTITUCIONET EDUKATIVE ARSIMORE DHE AFTËSUERE (IEAA)

- Mbajnë Task Forcat në nivel të IEAA operacionale
- Në ditën e parë të mësimi, informojnë nxënësit/fëmijët dhe personelin arsimor për rregullat dhe masat për parandalim të COVID-19, sipas udhëzuesve të IKSHPK;
- Ofrojnë informata mbi pandeminë dhe masat parandaluese që duhet të merren nga nxënësit/fëmijët dhe personeli arsimor varësisht nga ambienti/rrethanat ku gjenden (mënyrën e sjelljes në rastet kur janë vetëm, në grup, gjatë aktiviteteve, etj.);
- Sigurohen që materialet edukative-informuese janë të ekspozuara në vende të dukshme për nxënësit në të gjitha hapësirat shkollore apo edhe online;
- Mbajnë përgjegjësinë kryesore për realizimin e procesit edukativ-arsimor sipas skenarëve të miratuar nga MASHTI dhe rekomandimet e IKSHPK;
- Ofrojnë mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore për të gjithë fëmijët/nxënësit pavarësisht rrethanave pandemike;
- Realizojnë aktivitete vetëdijësimi mbi rëndësinë e vaksinimit të komunitetit shkollor e prindërve për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe shëndetin e mirëqenien e fëmijëve e të gjithë të tjerëve;
- Me mbështetje të TF në IEAA, organizojnë klasat dhe hapësirat sipas skenarëve;
- Ofrojnë shërbime mbështetëse të Teknologjisë Informative përmes koordinorit/es;
- Hartojnë plan për të ushqyerit e fëmijëve në grupe të vogla, duke respektuar distancën fizike.

KËSHILLI DREJTUES (KD) I IEAA

- Takohet sipas funksionit të përcaktuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar;
- Mban Task Forcën në nivel të IEAA operacionale;
- Shqyrton raportet mujore të IEAA.

MENAXHMENTI I IEAA

- Në koordinim me TF në IEAA, bën planifikimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor sipas skenarëve;
- Koordinon organizimin e procesit mësimor sipas skenarëve dhe i raporton rregullisht DKA-së;
- Siguron respektimin e masave sipas protokollit COVID-19 dhe vaksinimin e personelit;
- Evidenton fëmijët/nxënësit që nuk kanë pajisje të ndjekin edukimin dhe siguron që të ndërmerren masa për ta mundësuar realizimin e përmbajtjes edukative sipas skenarëve;
- Evidenton edukatorët/mësimdhënësit që kanë nevojë për përkrahje shtesë për mësimin në distancë;
- Informon edukatorët/mësimdhënësit/aktivet e lëndëve dhe të klasave për udhëzuesin;
- Cakton një koordinator për teknologji dhe platforma;
- Bashkëpunon me prindërit/kujdestarët ligjorë, për t'u mundësuar fëmijëve një kalim të natyrshëm nga ambienti i shtëpisë në IEAA;
- Informon prindërit/kujdestarët ligjorë për masat që zbaton IEAA, planin e veprimit dhe kërkon bashkëpunim për raportim të secilit rast të COVID-19 që ndodh në familje;
- Evidenton personelin dhe fëmijët që janë në rrezik të lartë për shkak të moshës ose gjendjes shëndetësore;
- Ndërmerr masa për zëvendësimin e personelit sipas nevojës.

KRYETARËT E AKTIVEVE

- Komunikojnë me anëtarët e aktivitetit me qëllim të përcjelljes së detyrave nga udhëheqja (menaxhmenti) dhe Këshilli i IEAA për respektim të masave dhe vaksinim;
- Bashkëpunojnë në planifikim të procesit mësimor dhe ofrimit të mbështetjes për mësimdhënësit dhe të tjerët;
- Këshillojnë mësimdhënësit, u ndihmojnë për tejkalimin e problemeve dhe përcjellin realizimin e kurrikulës bërthamë dhe njësive mësimore;

- Mbajnë komunikim të vazhdueshëm me kujdestarët e klasave dhe me mësimdhënësit për realizimin e procesit mësimor.

MËSUESIT KLASORË DHE EDUKATORËT PARAFILLORE (PËR KLASAT 0-5)

- Realizojnë procesin mësimor sipas skenarëve të detajuar në këtë udhëzues;
- Kujdesen për respektimin e masave sipas protokollit COVID-19;
- Informojnë prindërit/kujdestarët ligjorë të fëmijëve për formën e organizimit të procesit mësimor përgjatë vitit shkollor;
- Në raste të mësimi të kombinuar, kujdesen për angazhimin dhe kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe pjesëmarrjen në mësim të të gjithë nxënësve

MËSUESIT LËNDORË DHE KUJDESTARËT E KLASAVE (PËR KLASAT 6-12)

MËSUESIT LËNDORË:

- Realizojnë procesin mësimor sipas skenarëve të detajuar në këtë udhëzues;
- Kujdesen për respektimin e masave sipas protokollit COVID-19;
- Informojnë prindërit/kujdestarët ligjorë të fëmijëve për formën e organizimit të procesit mësimor përgjatë vitit shkollor;
- Në raste të mësimi të kombinuar, kujdesen për angazhimin dhe kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe pjesëmarrjes në mësim të të gjithë nxënësve;
- Organizojnë grupe virtuale me nxënësit e paraleles së vet në shkollë ose nga shtëpia, në rastet kur paraqitet kjo nevojë (p.sh., klasa nuk ka hapësirë të mjaftueshme sipas protokollit COVID-19, ndërsa IEAA ka hapësirë të lirë dhe kapacitete teknike për mësim në distancë);

KUJDESTARËT E KLASAVE:

- Komunikojnë me mësimdhënësit e angazhuar në punë me klasën ku kujdestarojnë;
- Përcjellin orarin e mësimi në distancë dhe komunikojnë me prindërit për angazhimin e rregullt të nxënësve;
- Mbajnë mbledhje të prindërve, fizike ose virtuale, sipas kushteve;
- Përcaktojnë një ditë të konsultimeve me klasat e veta;
- Organizojnë mbështetjen e ndonjë grupi të nxënësve me prani të herëpashershme në shkollë, sipas nevojës dhe skenarëve në fuqi.

PRINDËRIT

- Ua shpjegojnë apo ua rikujtojnë fëmijëve masat e parandalimit të COVID-19 (mbajtja e maskës, mbajtja e higjienës dhe mbajtja e distancës fizike);
- Shfrytëzojnë të drejtën e vaksinimit për fëmijët mbi 12 vjeç me indikacione shëndetësore;
- Krijojnë kushte dhe mjedis të përshtatshëm që fëmijët e tyre të marrin pjesë rregullisht në procesin mësimor, përfshirë edhe mësimin në distancë;
- Ofrojnë mbështetje për fëmijët, jo duke i kryer detyrat në vend të fëmijës, por përmes këshillave, sqarimeve dhe ndihmës që fëmija të arrijë t'i kuptojë dhe t'i përfundojë ato vet;
- Bashkëpunojnë me mësimdhënësit për të siguruar mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve të tyre;
- Mbajnë komunikim të rregullt me edukatorët/mësimdhënësit për të marrë sa më shumë informata lidhur me procedurat e zbatimit të skenarëve, sipas kushteve;
- Kontribuojnë në organizimin e procesit mësimor me prani fizike dhe/ose në distancë.

3

SKENARËT



3. SKENARËT

Viti shkollor 2020/2021 nuk ishte vit i zakonshëm shkollor, andaj të gjithë akterët e përfshirë në arsimin parauniversitar duhet të mobilizohen dhe të planifikojnë veprimet përkatëse sipas të katër skenarëve të mundshëm, varësisht nga niveli i arsimit dhe gjendja epidemiologjike.

Me këtë dokument planifikohen katër skenarë dhe mbetet që komunat t'i miratojnë skenarët, varësisht prej situatës epidemiologjike. IEAA obligohen ta kenë të gatshëm një plan veprimi organizativ, së paku për gjysmë-vjetorin e parë të vitit shkollor 2021/22 për të katër skenarët.

| SKENARËT për institucionet edukativ-arsimore dhe aftësuese | | |
|--|---|---|
| PËRSHKRIMI | INFRASTRUKTURA | MASAT/PËRMBLEDHJE (Masat e detajuara higjienike, organizative dhe metodologjike gjenden në kapitujt e veçantë) |
| SKENARI I RIKTHIMIT Mësimi me prani fizike dhe orar të plotë (45 minuta ora mësimore) me respektim të masave sipas protokollit COVID-19 (aty ku klasat kanë hapësirë të mjaftueshme) | <ul style="list-style-type: none"> • Ajrosja • Tualetet • Mjetet dezinfektuese • Posterët informues • Interneti • Kabinetet • Laboratorët • Hapësirat përcjellëse • Materialet edukative | <ul style="list-style-type: none"> • Mbajtja e maskave gjatë gjithë kohës (përveç fëmijët nën moshën 5 vjeç, fëmijët me aftësi të kufizuara/dëmtime intelektuale dhe rastet kur me udhëzim të mjekut është rekomanduar mosmbajtja e maskës); • Mbajtja e vazhdueshme e higjienës së duarve; • Mbulimi i gojës me krah gjatë kollitjes dhe tesh-timës; • Ajrosja e hapësirës/klasës në vazhdimësi; • Dezinfektimi i hapësirës/klasës pas çdo ndërrimi; • Pastrimi i hapësirave sipas manualit dy herë në ditë; • Zbatimi i masave për mbajtjen e distancës brenda dhe jashtë klasës; • Zbatimi i masave shtesë ose rishikimi i aktiviteteve me rrezik më të lartë (p.sh. këndimi, sportet); • Sigurimi i distancës 1 metër në mes të nxënësve; • Caktimi i vendit për secilin fëmijë/nxënës dhe mos lejimi i ndërrimit të vendeve; • Sigurimi i ushqimit dhe transportit të sigurt; • Organizimi i përkrahjes për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë (mësim plotësues, ose orë shtesë); • Hartimi i planeve për zëvendësimin e mësimdhënësve nga TF në IEAA. |

| | | |
|---|--|--|
| <p>SKENARI A</p> <p>Organizimi i procesit mësimor me prani fizike në grupe dhe orar të reduktuar - 30 minuta ora mësimore (aty ku klasat nuk kanë hapësirë të mjaftueshme) me respektim të masave sipas protokollit COVID-19</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Ajrosja • Tualetet • Mjetet dezinfektuese • Posterët informues • Interneti • Google Suite/Platforma • TV + e-Mësimi • Platformat online • Materialet edukative | <ul style="list-style-type: none"> • Mbajtja e vazhdueshme e higjienës së duarve • Mbulimi i gojës me krah gjatë kollitjes dhe teshtimës; • Ajrosja e hapësirës/klasës pas çdo ore mësimi; • Dezinfektimi i hapësirës/klasës pas çdo ndërrimi; • Pastrimi i hapësirave sipas protokollit COVID-19 dy herë në ditë; • Mbajtja e maskave; • Zbatimi i masave për mbajtjen e maskave dhe distancës brenda dhe jashtë grupit/klasës; • Zbatimi i masave shitesë ose rishikimi i aktiviteteve me rrezik më të lartë (p.sh. këndimi, sportet); • Sigurimi i distancës 1 metër në mes të tavolinave; • Caktimi i vendit për secilin fëmijë/nxënë dhe mos lejimi i ndërrimit të vendeve; • Mbajtja e distancës gjatë pushimit; • Sigurimi i ushqimit dhe transportit të sigurt; • Organizimi i përkrahjes për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë (mësim plotësues, ose orë shitesë); • Planifikimi i orarit të rotacionit për personelin; • Planifikimi i orarit të takimeve fizike; • Planifikimi i orarit për krijimin dhe vendosjen e materialeve; • Planifikimi i orarit për takimet me pedagogë/psikologë apo për aktivitete psiko-sociale; • Hartimi i planeve për zëvendësimin e mësimdhënësve nga TF në IEAA. |
| <p>SKENARI B</p> <p>Organizimi i procesit mësimor të kombinuar dhe me orar të reduktuar - 30 minuta ora mësimore (prani fizike dhe mësim në distancë)</p> <p>Izolimi i një apo më shumë nxënësve dhe kontakteve të ngushta e dërgon klasën në skenarin B</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Pajisja e nxënësve dhe mësimdhënësve me laptopë/tabletë • Interneti • TV + e-Mësimi • Platformat online • Materialet edukative | <ul style="list-style-type: none"> • Mbajtja e vazhdueshme e higjienës së duarve; • Mbulimi i gojës me krah gjatë kollitjes dhe teshtimës; • Ajrosja e hapësirës/klasës pas çdo ore mësimi; • Dezinfektimi i hapësirës/klasës pas çdo ndërrimi; • Pastrimi i hapësirave sipas protokollit COVID-19 dy herë në ditë; • Mbajtja e maskave; • Zbatimi i masave për mbajtjen e maskave dhe distancës brenda dhe jashtë grupit/klasës; • Zbatimi i masave shitesë ose rishikimi i aktiviteteve me rrezik më të lartë (p.sh. këndimi, sportet); • Zbatimi i distancës 1 metër në mes të tavolinave; • Caktimi i vendit për secilin fëmijë/nxënë dhe mos lejimi i ndërrimit të vendeve; • Mbajtja e distancës gjatë pushimit; • Sigurimi i ushqimit dhe transportit të sigurt; • Organizimi i përkrahjes për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë (mësim plotësues, ose orë shitesë); • Planifikimi i orarit të rotacionit për personelin; • Planifikimi i orarit të takimeve fizike; • Planifikimi i orarit të mësimin në distancë; • Planifikimi i orarit për krijimin dhe vendosjen e materialeve; • Planifikimi i orarit për takimet me pedagogë/psikologë apo për aktivitete psiko-sociale; • Hartimi i planeve për zëvendësimin e mësimdhënësve nga TF në IEAA. |

SKENARI C

Organizimi i mësimit në distancë dhe me orar të reduktuar - 30 minuta ora mësimore

- TV + e-Mësimi
- Platformat online
- Materialet edukative
- Personeli vazhdon me prani fizike aty ku IEAA kanë qasje në Internet;
- Personeli i pranishëm respekton rregullat e përcaktuara sipas protokollit COVID-19;
- Përcaktohet orari i mësimit në distancë;
- Për raste të veçanta, respektohen masat për huazimin dhe kthimin e mjeteve digjitale;
- Monitorohet pjesëmarrja e nxënësve përmes evidentimit të vijueshmërisë;
- Planifikohet orari i takimeve me pedagogë/psikologë apo për aktivitete psiko-sociale;
- Bëhet përditësimi i rregullt i listës së kontakteve të nxënësve dhe prindërve;
- Organizohet përkrahja për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë (mësim plotësues, ose orë shtesë);
- Hartohen plane për zëvendësimin e mësimeve të zhvendësuesve nga TF në IEAA.

3.1 INFOGRAFI

MËSIMI FILLON ME SKENARIN RIKTHIMI OSE SKENARIN A
varësisht prej madhësisë së klasës (dhe numrit të nxënësve)

SKENARI RIKTHIMI
(Prani fizike me orar të plotë;
45 minuta ora mësimore)
Procesi mësimor të realizohet me prani fizike dhe me orar të plotë, me qëllim të normalizimit të procesit mësimor, duke respektuar masat e distancës dhe higjienës sipas Udhëzuesit

SKENARI A
(Prani fizike në grupe me orar të reduktuar; 30 minuta ora mësimore)
Procesi mësimor të realizohet me prani fizike në grupe (klasat me hapësirë të vogël dhe/ose numër të madh të nxënësve) duke respektuar masat e distancës dhe higjienës sipas Udhëzuesit. Orari përcaktohet nga IEAA bazuar në numër të nxënësve dhe hapësirat ekzistuese.

***I dyshuar: nxënës/ personel i dyshuar të jetë i sëmurë me COVID-19**

NGA SKENARI B NË SKENARIN RIKTHIMI APO SKENARIN A
Në rast të konfirmimit të rezultativ negativ për infektim me COVID-19, fëmijët/nxënësit e dyshuar kthehen në klasë dhe mësimi vazhdon sipas Skenarit Rikthimi ose Skenarit A.

DYSHIM PËR INFEKSION (IZOLIM)
Sapo të ketë një apo më shumë nxënës të dyshuar, atëherë:
1. Fëmija vendoset menjëherë në dhomë/klasë të veçantë
2. Kontaktohet prindi/kujdestari ligjor dhe IKSHPK
3. Dezinfectohen hapësirat e frekuentuara nga fëmija
4. Izolohen nxënësit e dyshuar
5. Raportohet mbi rastin dhe hapat e ndërmarrë tek TF në DKA me qëllim të evidentimit

GJURMIMI
1. Bëhet identifikimi i shpejtë i kontaktit/ëve të ngushtë/a, në bashkëpunim me autoritetet lokale të shëndetit publik
2. Procesi fillon menjëherë pas identifikimit të një rasti të konfirmuar dhe duhet të përfshijë kontaktet e ngushta në klasë/shkollë (shokët/ shoqet e klasës, mësimdhënësit/ et dhe stafin tjetër).
3. Kontaktet duhet të menaxhohen në bazë të kategorisë së ekspozimit.

SKENARI B
(mësim i kombinuar: prani fizike dhe mësim në distancë, orar i reduktuar; 30 minuta ora mësimore)
Klasa kalon në Skenarin B në rast të izolimit të një apo më shumë nxënësve dhe kontakteve të ngushta ku nxënësi/ja i/e dyshuar dhe kontaktet e ngushta futen në izolim. Nxënësit, të cilët e vijojnë mësimin në klasë, qëndrojnë në ambient të klasës me distancë 1m nga njëri-tjetri. IEAA duhet të vazhdojë me mësim të rregullt për nxënësit që vijojnë mësimin me prani fizike. Varësisht nga gjendja shëndetësore e nxënësit/nxënësve të izoluar, IEAA duhet të ofrojë mbështetje për ndjekje të mësimin në distancë, apo materiale të duhura për mësimnxënie në kushte shtëpie.

Kontakt i ngushtë është personi:
o Që ka pasur kontakt ballë për ballë me rastin e konfirmuar COVID-19 në distancë prej një metër;
o Që ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë të pambrojtur me sekrecione infektive nga një rast i konfirmuar COVID-19;
o Që ka udhëtuar së bashku me një rast të konfirmuar COVID-19 për më shumë se 15 minuta duke përdorur mënyra të ndryshme të transportit;

A kanë rezultuar fëmija/nxënësi dhe kontakti i ngushtë pozitiv në testin për infektim me COVID-19?

Hapësire e vogël, sipas IKSHPK, llogaritet kur distanca në mes nxënësve është më e vogël se 1 metër

SKENARI C
(mësimi në distancë me orar të reduktuar; 30 minuta ora mësimore)
Klasa apo shkolla kalon në Skenarin C varësisht nga numri i rasteve dhe situata epidemiologjike, dhe bazuar në vendimin e TF në shkollë në koordinim me TF në DKA dhe në përputhshmëri me rekomandimet e IKSHPK. IEAA duhet t'i shqyrtojë të gjitha mundësitë që mësimdhënësit t'i shfrytëzojnë hapësirat e IEAA, që të ofrohet mbështetje dhe të ushtrohet mbikëqyrja e domosdoshme. Në rast të punës së mësimdhënëseve nga shtëpia, duhet të aplikohet evidentimi i rregullt i orëve të mbajtura. Duhet evidentuar nxënësit që nuk kanë pajisje teknologjike për të shqyrtuar mundësinë që këto pajisje të sigurohen përmes DKA-së ose donatorëve. Të gjithë nxënësve duhet ofruar udhëzime për shfrytëzimin e teknologjisë për qëllime të mësimin në distancë. TF ben monitorim dhe vlerësim të rregullt për rikthimin në Skenarin B, A ose Rikthimi në koordinim me TF në DKA dhe në përputhshmëri me rekomandimet e IKSHPK.

1. Mësimi vazhdon me Skenarin B
2. Bëhet monitorimi i përhapjes
3. Realizohet vlerësimi i vazhdueshëm i situatës nga TF në shkollë dhe koordinimi me TF në nivel të DKA, në përputhshmëri me rekomandimet e IKSHPK.

A ka vazhduar rritja e numrit të rasteve të dyshuara/infektuara?



4

PROCESI EDUKATIV PËR FËMIJËT PARASHKOLLOR



Të shmangët lëvizja e fëmijëve nga njëri grup në tjetrin apo ndryshimi/bashkimi i grupeve!

4. PROCESI EDUKATIV PËR FËMIJËT PARASHKOLLOR

Institucionet parashkollore (IP) janë ndër të parat që janë rihapur gjatë vitit 2020 dhe kanë vazhduar të punojnë në kushte shumë të vështira, duke mbështetur kështu jo vetëm fëmijët në zhvillimin e tyre, por gjithashtu duke krijuar mundësi për rikthim në punë të prindërve/kujdestarëve ligjorë. Në vitin edukativ-shkollor 2021/22, menaxhimi i situatës së krijuar nga COVID19 është bërë edhe më sfidues, duke pasur parasysh se virusi tashmë prek edhe fëmijët e vegjël. Andaj për ta menaxhuar sa më mirë këtë situatë, kërkohet angazhim shtesë i të gjithë akterëve për respektim të udhëzimeve të IKSHPK përmes krijimit të një mjedisi të sigurt, të këndshëm, stimulues dhe që promovon shëndetin fizik, sigurinë emocionale, lidhjet shoqërore dhe të nxënies për fëmijët e vegjël. Bashkëpunimi dhe komunikimi gjithëpërfshirës dhe i hershëm midis palëve, do të jetë kyç për zbatimin e masave të përcaktuara.

HYRJE/DALJET DHE DISTANCA NË HAPËSIRAT E INSTITUCIONIT PARASHKOLLOR (IP)

- Hyrje-daljet rregullohen sipas orarit të hartuar nga drejtorët e IP dhe të monitoruar nga edukatori/personeli i autorizuar nga IP-të, i cili vendoset në hyrje të çdo objekti;
- Pranim-dorëzimi i fëmijëve nga personi i autorizuar, duke i respektuar masat e protokollit COVID-19, planifikohet bazuar në infrastrukturën dhe numrin e personelit në dispozicion në IP;
- Fëmijët dhe personeli me të hyrë në IP obligohen t'i pastrojnë duart me shampun/sapun për 20-30 sekonda;
- Prindërit/kujdestarët ligjorë (apo personat e autorizuar nga familja) duhet t'i sjellin dhe marrin fëmijët duke respektuar me përpikëri orarin e përcaktuar nga IP;
- Dera e IP duhet të qëndrojë e mbyllur gjatë kohës që fëmijët janë brenda.

KONTAKTI ME PRINDËR

- Kontaktet me prindër/kujdestarë ligjorë bëhen përmes mjeteve të komunikimit (Zoom, Viber, telefon, Google Meet, etj), apo në ambient të hapur me distancë sipas rekomandimeve të IKSHPK;
- Në rast nevojë, për komunikim me edukatoren apo drejtorin e IP, përdoret vetëm komunikimi elektronik.

MASKAT

- Personeli dhe të gjitha palët që frekuentojnë hapësirat e IP duhet të mbajnë maska brenda IP gjatë gjithë kohës;
- Maskat nuk rekomandohen për fëmijët e moshës 2-5 vjeç¹⁶;
- Maskat **nuk** mund të përdoren për fëmijët në moshën 2 ose nën 2 vjeç për shkak të rrezikut të ngulfatjes.

DISTANCIMI FIZIK GJATË QËNDRIMIT NË INSTITUCION PARASHKOLLOR

Rekomandohet shfrytëzimi maksimal i ambienteve të IP, për ta ruajtur distancën fizike në grupet me numër të madh të fëmijëve.

- Fëmijët e një grupi duhet të qëndrojnë në të njëjtën sallë/dhomë çdo ditë dhe me të njëjtit edukatorë/e (edukatorët/et e grupit);
- Gjatë procesit edukativ, edukatorët/et qëndrojnë duke respektuar distancën dhe rekomandohet të përpiqen t'i vendosin fëmijët në distancë nga njëri-tjetri (p.sh. rreth një tavoline me 10 karrige ulen 5 fëmijë);
- Lojërat me njëri-tjetrin, apo aktivitete të tjera, duhet të organizohen në mënyrë që të respektohet gjithmonë brenda mundësive distanca fizike midis fëmijëve;
- Në kohën e gjumit të shfrytëzohet hapësira e dhomës maksimalisht duke i vendosur fëmijët larg njëri-tjetrit (respektohet distanca fizike);
- Mbulesat e gjumit shënjohen me iniciale të secilit fëmijë, në mënyrë që të shmanget përdorimi i tyre nga fëmijët e tjerë të grupit;
- Gjatë kësaj periudhe nuk lejohet organizimi i festave të ditëlindjeve dhe organizime të tjera festive në IP- të.

KUJDESI PËR HIGJENËN NË MJEDISËT E IP

- IP organizojnë aktivitete shtesë përmes të cilave fëmijët ndërgjegjësohen për rëndësinë që ka mbajtja e distancës fizike dhe higjienës personale në ambientet brenda dhe jashtë IP;
- Fëmijëve duhet t'u flitet në mënyrë të vazhdueshme përmes lojës lidhur me COVID-19, rregullat e higjienës, larjen e duarve, mënyrën e duhur të kollitjes dhe teshtitjes, etj.;
- Në ambientet e IP duhet të vendosen posterë mbi masat e parandalimit të infektimit me COVID-19, higjienën respiratore dhe atë personale si dhe rregullat për mbajtjen e distancës fizike, të dizajnuara në mënyrë sa më të thjeshtë, të përgatitura nga ana e edukatorëve/eve, në mënyrë që të jenë të kuptueshme nga fëmijët;
- Kur një fëmijë i ndërrohet pelena, paraprakisht edukatori/ja duhet t'i lajë duart dhe të vendos doreza.

¹⁶ https://www.who.int/publications/i/item/WHO-2019-nCoV-IPC_Masks-Children-2020.1

PËRGATITJA E USHQIMIT DHE SHËRBIMI I TIJ

- Duhet të zbatohet legjislacioni në fuqi për sigurinë e ushqimit dhe parimet e higjienës dhe sigurisë së ushqimit nga ana e personave përgjegjës (UA 03/2019 – për të ushqyerit e shëndetshëm të fëmijëve në IP);
- Fëmijët nuk duhet ta prekin ushqimin, pijet e askujt, apo t'i ndajnë enët dhe mjetet e tjera të ushqimit (lugët, pirunët etj.);
- Duhet të kufizohet hyrja e personave të tjerë për sa kohë që fëmijët janë duke ngrënë;
- Personeli që përgatit ushqimin duhet t'u përmbahet masave të përcaktuara në protokollin COVID-19;
- Mjetet dhe sipërfaqet që përdoren për përgatitjen e ushqimit duhet të lahen para dhe pas përdorimit të tyre;
- Lavamanët që përdoren për larjen dhe përgatitjen e ushqimit nuk duhet të përdoren për asgjë tjetër.
- Mjedisi ku kryhet ushqyerja e fëmijëve duhet të pastrohet dhe dezinfektohet para dhe pas ngrënies së çdo grupi të fëmijëve;
- Edukatorët/et duhet t'i lajnë duart gjithmonë para përgatitjes së ushqimit si dhe pasi t'u kenë ndihmuar fëmijëve për të ngrënë.
- Duhet të sigurohet distanca gjatë ngrënies dhe aktiviteteve të tjera;
- Fëmijët duhet t'i lajnë duart para dhe pas ngrënies sipas protokollit COVID-19.

PËRDORIMI DHE DEZINFEKTIMI I HAPËSIRAVE TË IP DHE AJROSJA E TYRE

- Hapësirat e frekuentuara duhet të dezinfektohen rregullisht, më së paku dy herë në ditë (para dhe pas përdorimit). Dezinfektimi duhet të bëhet sipas rekomandimeve të IKShPK;
- Duhet të dezinfektohen lodrat, mjetet didaktike dhe ambientet e secilit grup, çdo ditë;
- Në fund të çdo dite duhet të kryhet edhe dezinfektimi i mjediseve të përbashkëta;
- IP mbajnë evidencë mbi dezinfektimin e hapësirave;
- IP ajrosin hapësirat pas përdorimit, dhe së paku dy herë në ditë. Sipas mundësisë t'i mbajnë të hapura gjatë qëndrimit;
- IP sigurohen që në ambientet e tyre ka ujë të rrjedhshëm, sapun të lëngët, letra për tharjen e duarve dhe dezinfektues me përmbajtje alkooli 60% (kujdesen që fëmijët e vegjël të mos fusin dezinfektuesit në gojë);
- Tualetet duhet gjatë gjithë kohës të jenë funksionale dhe të furnizuara me ujë. Në rast të mungesës së ujit në tualete, IP duhet të raportojë tek TF në DKA;

- Duhet të shmanget grumbullimi i fëmijëve në tualete. Të organizohet në mënyrë që të ketë rend dhe distancë;
- Drejtuesi i IP duhet ta hartojë protokollin me oraret për pastrimin dhe dezinfektimin e IP;
- Pastrimi i këtyre objekteve nuk duhet të bëhet në prani të fëmijëve në dhomë/ambient;
- Korridoret dhe tualetet pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht sipas grafikut ditor;
- Largimi nga IP bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit të çdo ambienti të tij;
- Mbeturinat duhet të largohen çdo ditë dhe të hidhen në mënyrë të duhur.

PASTRIMI DHE DEZINFERTIMI I LODRAVE

- Lodrat, të cilat nuk mund të dezinfektohen, largohen nga përdorimi;
- Lodrat apo objektet që futen në gojë dhe që janë të ndotura me sekrecione duhet të largohen dhe të mos përdoren deri sa të dezinfektohen;
- Lodrat prej materiali që mund të lahen në rrobalarëse/pastrim kimik duhet të përdoren vetëm nga një fëmijë dhe më pas të lahen, para se të mund të përdoren nga një fëmijë tjetër;
- Lodrat apo mjetet didaktike nuk duhet të kalohen nga një grup në tjetrin, pa i larë apo pa i dezinfektuar ato;
- Librat e fëmijëve, si dhe materialet e tjera me bazë letre, si letra, zarf, revista, dosje nuk konsiderohen se përbëjnë rrezik të lartë për transmetim dhe nuk kanë nevojë për procedura shtesë të pastrimit ose dezinfektimit (kujdes foshnjat dhe fëmijët e vegjël).

PËR EDUKATORËT/ET

- Sipas mundësive, organizojnë aktivitete në grupe të vogla (2-3 fëmijë) për ta kufizuar grumbullimin e tyre;
- Përcaktojnë forma të përshtatshme për të përcjellë larjen e duarve dhe shpërblejnë fëmijët për larjen e shpeshtë/me kohë të duarve (p.sh. mund të këndojnë një këngë gjersa lajnë duart për të ushtruar kohëzgjatjen e rekomanduar prej minimum 20 sekondave).

RAST I DYSHUAR APO KONFIRMUAR ME COVID-19 NË IP

- Nëse paraqitet ndonjë rast me simptoma të COVID-19, duhet të izolohet në shoqërim të edukatores në një hapësirë të veçantë dhe të kontaktohet menjëherë prindi/kujdestari ligjor;
- IP sigurohet që të gjitha sipërfaqet që kanë qenë të frekuentuara nga të infektuarit/dyshuarit të dezinfektohen. Personi i caktuar për të pastruar hapësirën duhet të mbajë doreza dhe ta pastrojë klasën dhe orenditë me deterxhent e pastaj me një dezinfektues ose pastrues të kombinuar që përmban një hipoklorit (tretësirë zbardhuese);

- Drejtori/ja (ose një i deleguar nga ai/ajo për këtë përgjegjësi) do të marrë përsipër lajmërimin e prindit/kujdestarit ligjor për rastin e dyshuar. Gjithashtu, personi i caktuar duhet të jetë në kontakt me IKSHPK për udhëzime se si të veprohet tutje, në rast nevoje;
- Në bashkëpunim me prindin duhet të kontaktohen shërbimet shëndetësore/qendra e mjekësisë familjare më e afërt. Sipas protokollit COVID-19 “Sapo personi me COVID-19 të largohet nga hapësira ku ai/ajo ishte i izoluar, dhoma nuk duhet të pastrohet ose të përdoret për një orë dhe gjatë kësaj kohe dera e dhomës duhet të mbetet e mbyllur”¹⁷;
- Drejtori/ja duhet të raportojë mbi rastin dhe hapat e ndërmarra tek TF në DKA me qëllim të evidentimit për përcjelljen e situatës dhe potencialit të përhapjes, si dhe ta përditësojë raportin me zhvillimet e rastit;
- Sapo të paraqitet një rast i dyshuar me COVID-19 në IP, bëhet verifikimi nga edukatori/ja nëse janë zbatuar masat në klasën e caktuar;
- TF në institucion, në bashkëveprim me TF në DKA, merr vendim për vazhdimin e mësimin sipas skemës përkatëse.

GJURMIMI I KONTAKTEVE NË MJEDISIN E IP

- Të gjitha kontaktet që tashmë kanë simptoma ose zhvillojnë simptoma gjatë gjurmimit (kontaktet nga ekspozimi me rrezik të lartë dhe me rrezik të ulët) duhet të testohen sa më shpejt të jetë e mundur për të mundur izolimin e rastit dhe gjurmimin e mëtejshëm të kontakteve. Përveç kësaj, testimi i kontakteve asimptomatike të ekspozimit me rrezik të lartë mundëson izolimin e shpejtë të rasteve të reja të mundshme dhe gjurmimin e kontakteve të këtyre rasteve të reja. Kontaktet me rrezik të lartë në mjediset e IP-ve duhet të vendosen në karantinë dhe të përcillen në mënyrë aktive nga IP ose autoritetet e shëndetit publik.

Udhëzime specifike për fëmijët me nevoja të veçanta në IP

Varësisht prej formës se operimit në IP apo në distancë, fëmijët me nevoja të veçanta të moshës 0-6 vjeç mund të përdorin programin “Mësimdhënia me fusha të aktivitetëve”, e cila është specifike për këto grupmosha. Programi gjendet në Platformën <http://arsimigjitheperfs hires.rks-gov.net> ku për secilën fushë janë të zberthyera aktivitetet që mund të përdoren për të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta.

17 <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/06/Manual-p%C3%ABr-parandalimin-dhe-luftimin-e-COVID19.pdf>, fq.32.

SKENARI I RIKTHIMIT PËR IP

KTHIMI I FËMIJËVE NË IP
(Edukimi sipas grupmoshës në distancë prej së paku 1m nga njëri-tjetri)

Ky skenar kërkon që grupet e fëmijëve që kthehen në IP të qëndrojnë vetëm **në grupin e tyre** në ambient me distancë nga 1m, të respektohet distanca fizike duke pasur parasysh moshën e fëmijëve.

Orari

IP punojnë me orar të plotë duke respektuar masat e përcaktuara në këtë udhëzues dhe protokollin COVID-19.

SKENARI A PËR IP

Nuk është i aplikueshëm për këtë nivel të edukimit!

SKENARI B PËR IP

EDUKIMI I KOMBINUAR ME PRANI FIZIKE DHE EDUKIM NË DISTANCË
(Izolimi i një apo më shumë fëmijëve dhe kontakteve të ngushta e dërgon klasën në skenarin B)

Për fëmijët e izoluar nga COVID-19, varësisht nga gjendja shëndetësore e fëmijës, edukatori/ja i rekomandon prindit/kujdestarit ligjor përdorimin e platformës për mësim në distancë “Edukimin në distancë – kujdesi, zhvillimi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç” dhe u dërgon prindërve aktivitetin e ditës që duhet të realizohet me fëmijën, i cili/e cila ndodhet në izolim. Platforma është e qasshme përmes uebfaqes së MASHTI në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake dhe turke.

- Platforma: <https://edukimihershem.rks-gov.net/>
- Platforma për fëmijë me nevoja të veçanta: <http://arsimigjitheperfshires.rks-gov.net>

Edukatori/ja monitoron realizmin e aktiviteteve ditore gjatë kohës që fëmija është në izolim në komunikim të vazhdueshëm me prindin/kujdestarin ligjor.

SKENARI C PËR IP

EDUKIMI NË DISTANCË I FËMIJËVE NË IP

Në rast të nivelit të lartë të rrezikshmërisë dhe vendimit për mbylljen e çerdheve, edukimi në fëmijërinë e hershme realizohet përmes platformës për mësim në distancë online “Edukimin në Distancë – kujdesi, zhvillimi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç”.

- Platforma: <https://edukimihershem.rks-gov.net/>
- Platforma për fëmijë me nevoja të veçanta: <http://arsimigjitheperfshires.rks-gov.net>

Platforma është e qasshme edhe përmes uebfaqes së MASHTI në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake dhe turke.

5

PROCESI MËSIMOR
PËR KLASAT 0-12



5. PROCESI MËSIMOR PËR KLASAT 0-12

Task Forcat në IEAA kanë përgjegjësi t'i organizojnë klasat varësisht nga numri i nxënësve dhe hapësirës që kanë në dispozicion, gjithnjë në bashkëveprim me TF në DKA. Procesi mësimor në vitin shkollor 2021/22 realizohet sipas skenarëve (Rikthimi, A, B, apo C) bazuar në gjendjen epidemiologjike, në përputhje me infografin në faqe 21.

Mësimdhënësit/edukatorët e klasës janë të obliguar të bëjnë organizimin dhe mbikëqyrjen e aranzhimit të vendosjes/uljes së nxënësve në klasa dhe të sigurojnë që secili nxënës ta ketë vendin e caktuar dhe të mos bëhet ndërrimi apo bashkimi i grupeve.

Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e situatës dhe kujdesin për shëndetin e fëmijëve dhe shëndetin publik, TF në nivel të IEAA në bashkëpunim me TF në nivel të DKA vendos për zbatimin e skenarit përkatës (Rikthimit, A, B, C).

HYRJE/DALJET DHE DISTANCA NË HAPËSIRAT E SHKOLLËS

- Për hyrje dhe dalje të nxënësve IEAA i vendos në funksion të gjitha hyrjet e objektit;
- Në hyrje të IEAA, në koridore dhe klasa vendosen materiale edukative-informuese, udhëzues për mbrojtjen e shëndetit, sigurinë në shkollë dhe mjete për dezinfektimin e duarve;
- Për hyrje dhe dalje të kontrolluar në/nga IEAA, para/brenda në IEAA, caktohen përgjegjësit për mbajtjen e rendit me qëllim të mbajtjes së distancës së nevojshme mes nxënësve, në të gjitha rastet kur nxënësit ndodhen jashtë klasave, përfshirë edhe pushimin e gjatë;
- Prindërit/kujdestarët ligjorë dhe personat që nuk janë të punësuar në IEAA, apo nuk janë nxënës, ndalohet të hynë në hapësirat e IEAA, përveç në raste specifike të autorizuara nga drejtori/ja i/e IEAA. Rastet specifike ku lejohet hyrja në IEAA përfshinë: prindërit, kujdestarët, asistentët e fëmijëve me nevoja të veçanta, përfaqësuesit e organeve shtetërore që zbatojnë ose mbikëqyrin mbarëvajtjen e procesit edukativ-arsimor, shëndetin dhe mirëqenien dhe punëtorët e caktuar për mirëmbajtje, duke minimizuar mundësinë e kontaktit me nxënës;
- Ndalohen të gjitha përshëndetjet me kontakt fizik ndërmjet stafit të IEAA dhe në mes të nxënësve;

- Mësimdhënësit obligohen t'i shmangin grumbullimet në hapësirat e IEAA përfshirë edhe sallën e mësimdhënësve përtej orarit të tyre, dhe që punët administrative t'i kryejnë nga shtëpia. Gjithashtu rekomandohet që takimet të mbahen në mënyrë elektronike që të minimizohet kontakti fizik, për aq sa është e mundur;
- IEAA që kanë kuzhinë për fëmijët me qëndrim të zgjatur/ qendra burimore, duhet të respektojnë në përpikëri protokollin COVID-19.

KONTAKTI ME PRINDËR

- Kontaktet me prindër/kujdestarë ligjorë duhet të bëhen përmes mjeteve të komunikimit (Zoom, Viber, telefon, Google Meet, etj), apo në ambient të hapur me distancë, sipas rekomandimeve të IKSHPK;

MASKAT

- Personeli dhe të gjitha palët që frekuentojnë hapësirat e IEAA duhet të mbajnë maska brenda IEAA gjatë gjithë kohës, përveç fëmijëve me aftësi të kufizuara/dëmtime intelektuale dhe rastet kur me udhëzim të mjekut është rekomanduar mosmbajtja e maskës;
- Obligohet personeli i IEAA që ta mbikëqyr në mënyrë strikte bartjen e maskës në mënyrën e duhur, sipas udhëzimeve të IKSHPK;
- Udhëzimet e përdorimit të maskave të përcillen sipas protokollit COVID-19.

PËRDORIMI DHE DEZINFETIMI I HAPËSIRAVE TË IEAA DHE AJROSJA

- Hapësirat e frekuentuara sikurse klasat duhet të dezinfektohen rregullisht, në fillim dhe në fund të çdo ndërrimi, më së paku dy herë në ditë. Dezinfektimi të bëhet sipas rekomandimeve të IKSHPK;
- IEAA duhet të mbajnë evidencë mbi dezinfektimin e hapësirave;
- Pastrimi i sallave të ushqimit duhet të bëhet pas çdo përdorimi;
- Nxënësit duhet t'i lajnë duart para dhe pas ngrënies;
- IEAA duhet t'i ajrosin klasat pas çdo ore mësimore dhe së paku dy herë në ditë. Sipas mundësisë, dritaret në klasa duhet të jenë të hapura gjatë orarit të mësimin (duke i marrë parasysh rregullat e sigurisë);
- IEAA sigurohen që ka ujë të rrjedhshëm, sapun të lëngët, letra për tharjen e duarve dhe dezinfektues me përmbajtje alkooli 70% në ambientet e institucionit;
- Tualetet duhet gjatë gjithë kohës të jenë funksionale dhe të furnizuara me ujë. Në rast të mungesës së ujit në tualete, IEAA duhet të bëjë raportimin tek TF në DKA në mënyrë që të gjendet një zgjidhje;
- Duhet të shmangët grumbullimi i nxënësve në tualete. Të organizohet ashtu që të ketë rend dhe distancë.

RAST I DYSHUAR APO KONFIRMUAR ME COVID-19 NË SHKOLLË

- Nëse paraqitet ndonjë rast me simptoma të COVID-19, duhet të vendoset menjëherë në dhomë/klasë të veçantë, e cila duhet të jetë e përcaktuar nga IEAA, dhe të kontaktohet prindi;
- IEAA sigurohet që të gjitha sipërfaqet që kanë qenë të frekuentuara nga të infektuarit/dyshuarit të dezinfektohen. Personi i caktuar për të pastruar dhomën (klasën) duhet të mbajë doreza dhe ta pastrojë klasën dhe orënditë me deterxhent e pastaj me një dezinfektues ose pastrues të kombinuar që përmban një hipoklorit (tretësirë zbardhuese);
- Drejtori/ja (ose një i/e deleguar nga ai/ajo për këtë përgjegjësi) merr përsipër lajmërimin e prindit/kujdestarit ligjor për rastin e dyshuar. Gjithashtu, personi i caktuar duhet të jetë në kontakt me IKSHPK për udhëzime se si të veprohet tutje;
- Në bashkëpunim me prindin, kontaktohen shërbimet shëndetësore/qendra e mjekësisë familjare më e afërt. Sipas udhëzimeve të IKSHPK “Sapo personi me COVID-19 të largohet nga dhoma ku ai ishte i izoluar, dhoma nuk duhet të pastrohet ose të përdoret për një orë dhe gjatë kësaj kohe dera e dhomës duhet të mbetet e mbyllur”;
- Drejtori/ja duhet të raportojë mbi rastin dhe hapat e ndërmarra tek TF në DKA me qëllim të evidentimit dhe përcjelljes së situatës dhe për shkak të potencialit të përhapjes, si dhe ta përditësojë raportin me zhvillimet lidhur me rastin;
- Sapo të paraqitet një rast i dyshuar me COVID-19 në IEAA, bëhet verifikimi nga mësimdhënësi nëse janë zbatuar masat në klasën përkatëse;
- TF në IEAA në bashkëveprim me TF në DKA merr vendim për vazhdimin e mësimin sipas [skemës](#) përkatëse.

GJURMIMI I KONTAKTEVE NË MJEDISIN E IEAA

- Të gjitha kontaktet që tashmë kanë simptoma ose zhvillojnë simptoma gjatë gjurmimit (kontaktet nga ekspozimi me rrezik të lartë dhe me rrezik të ulët) duhet të testohen sa më shpejt të jetë e mundur për të mundur izolimin e rastit dhe gjurmimin e mëtejshëm të kontakteve. Përveç kësaj, testimi i kontakteve asimptomatike të ekspozimit me rrezik të lartë mundëson izolimin e shpejtë të rasteve të reja të mundshme dhe fillimin e gjurmimit të kontakteve të këtyre rasteve të reja;
- Kontaktet me rrezik të lartë (kontakti i ngushtë) në mjediset e IEAA duhet të vendosen në karantinë dhe të përcillen në mënyrë aktive nga IEAA ose autoritetet e shëndetit publik¹⁸.
- Kontakt i ngushtë është personi që:
 - Ka pasur kontakt ballë për ballë me rastin e konfirmuar COVID-19 në distancë prej 1 metër;
 - Ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë të pambrojtur me sekrecione infektive nga një rast i konfirmuar COVID-19 (p.sh. gjatë kollitjes);
 - Ka udhëtuar së bashku me një rast të konfirmuar COVID-19 për më shumë se 15 minuta duke përdorur mënyra të ndryshme të transportit.

¹⁸ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/COVID-19-in-children-and-the-role-of-school-settings-in-transmission-second-update.pdf>

SKENARI I RIKTHIMIT PËR KLASAT 0-12

KTHIMI I NXËNËSVE NË SHKOLLA
(në distancë prej së paku 1m nga njëri-tjetri)

Skenari i Rikthimit është përpiluar me synim që procesi mësimor për vitin shkollor 2021/22 në Kosovë të realizohet me prani fizike dhe me orar të plotë, me qëllim të normalizimit të procesit mësimor.

- Skenari i Rikthimit zbatohet në klasa që kanë hapësirë të mjaftueshme për organizimin e procesit mësimor me orar të plotë dhe me prani fizike (p.sh. një klasë, ku distanca në mes të nxënësve është së paku 1 metër);
- TF në IEAA kanë përgjegjësi t'i organizojnë klasat varësisht nga numri i nxënësve dhe hapësirës që kanë në dispozicion dhe në bashkëveprim me TF në DKA;
- IEAA inkurajohet që të shfrytëzojë hapësira brenda tij që mund të shndërrohen në klasa të mësimi, sikurse sallat, laboratorët apo të ngjashme;
- Gjatë hyrjes dhe daljes në klasë dhe gjatë orarit të mësimi, mësimdhënësit duhet të sigurohen që nxënësit i dezinfektojnë duart.

ZBATIMI I KURRIKULËS

- Procesi edukativ-arsimor zhvillohet sipas KKK, kurrikulave bërthamë, fushës, programeve lëndore dhe kalendarit mësimor.

ORARI

- IEAA e organizojnë procesin mësimor me orar të plotë (45 minuta ora mësimore).

SKENARI A PËR KLASAT 0-12

KTHIMI I NXËNËSVE NË SHKOLLA NË GRUPE
(në distancë prej së paku 1m nga njëri-tjetri)

PRANIA NË KLASË 0-12

Aty ku klasat kanë hapësirë të vogël dhe/ose kanë numër të madh të nxënësve duhet të kalojnë në skenarin A me prani fizike në grupe. Hapësirë e vogël, sipas IKSHPK, llogaritet kur distanca në mes të nxënësve është më e vogël se 1 metër.

ZBATIMI I KORNIZËS KURRIKULARE DHE ORARI

Zbatimi i Kornizës Kurrikulare: Kurrikula Bërthamë Programet Mësimore/ Lëndore

Sipas Planit për e-Mësimin, përfshihen “shtatë fushat kurrikulare për të gjitha klasat 0-9”, “së paku 75% ose $\frac{3}{4}$ e fondit të orëve”, ku “të gjitha lëndët kryesore në e- Mësimi duhet të përfshihen me fond të plotë të orëve (përveç lëndëve që kanë mbi 5 orë në javë)” dhe duke zvogëluar fondin e orëve për 30% në fusha/lëndë të caktuara, të cilat për shkak të karakteristikave specifike është vështirë të realizohen përmes mësimi në distancë¹⁹.

¹⁹ https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezesi-final-file-10-09-2020_1.pdf

Planifikimi edhe për skenarin A bëhet sipas propozimit për reduktimin e përmbajtjeve për 25%.

Për klasat 10-12

Sipas Udhëzuesit të MASHTI²⁰ realizohet zbatimi i kufizuar në lëndët kryesore (gjuhë, matematikë, shkenca natyrore dhe lëndë shoqërore) varësisht nga tipi i gjimnazit. Për shembull, gjimnazet gjuhësore do të përqendroheshin në lëndët gjuhë, matematikë dhe gjuhët kryesore, ndërsa gjimnazet shkencore do të përqendroheshin në gjuhë, matematikë dhe shkenca natyrore e të tjera, sipas tipit të gjimnazit. Planet e detajuara miratohen nga divizioni i kurrikulave në MASHTI.

ORARI

Orari mësimor përcaktohet nga IEAA bazuar në numër të nxënësve dhe hapësirat ekzistuese. IEAA e organizojnë procesin mësimor në grupe, me orar të reduktuar (30 minuta ora mësimore).

Për klasat 10 – 12 në institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional (IAAP) të mbahet mësim i rregullt sipas planifikimit të përcaktuar. Duke pasur parasysh që IAAP kanë numër më të vogël të nxënësve, ato duhet të punojnë me orar të plotë. IAAP mund të zbatojnë modele të kombinuara të të mësuarit, një kombinim të mësimit në klasë dhe mësimit në punëtori.

Disa nga masat praktike që IAAP duhet të ndërmarrin përfshijnë:

- Planifikimi/orari i mësimit bazuar në numrin e nxënësve (duke pasur parasysh se mund të ketë masa apo orare të caktuara të lëvizjes së qytetarëve varësisht nga situata dhe komuna/qyteti)
- Kalimi/formimi i klasave në hapësira të përkohshme ose jashtë apo në punëtori për profilet me më shumë nxënës.
- Mbajtja e mësimit në ndërrime, ndarja e nxënësve në grupe të vogla.

Mësimi në klasë 1: Mësim individual për të gjithë nxënësit. Në këtë model planifikimin IAAP duhet ta bëjnë me sa më pak nxënës në grupe, maksimum 10 nxënës dhe hapësirën e paraparë prej 1m midis nxënësve dhe mësimitdhënësve. Aktivitetet dhe programet jashtëshkollore duhet të vazhdojnë të ndiqen duke dërguar numër të caktuar të nxënësve (grupe të vogla, p.sh.5 nxënës për grup).

Mësimi në ndërmarrje 2: Praktika profesionale në kompani duhet të organizohet në atë mënyrë që kompanitë të dëshmojnë se i respektojnë të gjitha kërkesat e parapara me vendim të qeverisë, ku hyjnë dezinfektimi i punëtorive si dhe dëshmia e vaksinimit, dëshmia që e kanë kaluar COVID-19 apo që nuk janë të infektuar për instruktorët/et që do të punojnë me nxënësit.

Lëndët të cilat nxënësit mund të dalin jashtë, si p.sh edukata fizike, këshillohet që të mbahen në ambient të hapur duke respektuar distancën dhe masat e sigurisë.

20 udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme Të larta (shml) https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti_1.pdf

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Gjatë procesit mësimor inkurajohen mësimdhënësit të bashkëpunojnë në mënyrë që të sigurojnë mësimdhënie cilësore për të gjithë fëmijët. Mësimdhënësit të përdorin mjete digjitale dhe platforma për të zhvilluar njësi mësimore të shoqëruara me shpjegime shtesë dhe detyra në klasë, skenarët e tjerë si:

- videot në RTK
- videot nga Khan Academy, National Geographics, History Channel, etj.

Në këtë mënyrë, nxënësit do të përgatiten dhe familjarizohen me metodën e kombinuar kur ndërrojnë skenarët.

Përqëndrimi është tek mirëqenia e nxënësve dhe krijimi i shprehive për vetëdrejtim, ndjekja e masave të shëndetit, socializimi në kushte të sigurta, identifikimi i problemeve në të nxënë dhe përkrahja e tyre që kanë më shumë nevojë.

UDHËZIME PËR VLERËSIM

Përqëndrimi të jetë tek arritja e rezultateve të përcaktuara në programet lëndore. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzuesin për vlerësim të miratuar nga MASHTI.

Udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta i kanë specifikat e tyre andaj kërkojnë qasje dhe punë individuale. Secili IEAA dhe secili mësimdhënës që në klasë ka fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta, duhet ta përfshijë nxënësin në procesin mësimor me gjithë klasën, por në raste të caktuara të mbajë takime/punë individuale në mënyrë që fëmija/nxënësi të angazhohet dhe t'i përforcojë njohuritë dhe shkathtësitë e përcaktuara në Planin Individual të Arsimit (PIA).

Në IEAA, ku janë të punësuar mësuesit mbështetës dhe asistentët, duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë me edukatorët/ mësuesin/en e klasës apo mësimdhënësit lëndorë. Kjo duhet të bëhet përmes planifikimit të përbashkët në mënyrë që të koordinohen aktivitetet dhe intervenimet, që përkrahja të bëhet në mënyrë të harmonizuar dhe me qëllimin e njëjtë për të zhvilluar dhe për të rritur aftësitë dhe shkathtësitë e fëmijës në fushat e përcaktuara me PIA etj.

Mësimdhënësit, mësuesit mbështetës dhe asistentët duhet të kenë kontakte të rregullta me qendrat burimore me të afërta për të marrë përkrahje profesionale-pedagogjike bazuar në nevojat individuale të fëmijës. Gjithashtu të gjitha shkollat, edukatorët dhe mësimdhënësit mund ta shfrytëzojnë platformën asimigjithëpërfshires.rks-gov.net, e cila ofron materiale pedagogjike të modifikuara dhe të personalizuar për nxënësit me nevoja të veçanta, por edhe me materiale pedagogjike shtesë për mësimdhënës dhe prindër.

SKENARI B PËR KLASAT 0-12

MËSIMI I KOMBINUAR ME PRANI FIZIKE DHE MËSIM NË DISTANCË
(Izolimi i një apo më shumë nxënësve dhe kontakteve të ngushta e dërgon klasën në skenarin B)

Mësimi i kombinuar organizohet për një ose më shumë nxënës që dyshohet/hen ose që është/ janë i/e/të konfirmuar me COVID-19, me qëllim të vijimit të mësimit të rregullt nga distanca. (p.sh. një nxënës i izoluar kyçet në procesin mësimor në klasë në kohë reale përmes pajisjes nga shtëpia).

Ky skenar kërkon që nxënësit, të cilët e vijnë mësimin në klasë, të qëndrojnë në ambient të klasës me distancë 1m nga njëri-tjetri.

Në rast se organizohet mësim i kombinuar, për IAAP ka përparësi mbajtja e lëndëve praktike në shkollë si dhe në kabinete/ punëtori, ndërsa përmes mësimit plotësues në distancë mund të mbahen lëndët e përgjithshme dhe teorike. Gjithashtu përparësi t'u jepet nxënësve më të pafavorizuar dhe mbajtjes së mësimit plotësues.

ORARI

IEAA e organizojnë procesin mësimor të kombinuar, me prani fizike dhe në distancë, me orar të reduktuar (30 minuta ora mësimore).

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Gjatë kontaktit fizik mbulohen çështjet më të rëndësishme, të cilat nxënësit mund të kenë pasur problem për t'i kuptuar. Prania fizike po ashtu shërben për t'u ndihmuar nxënësve që të familjarizohen me metodat virtuale, përdorimin e pajisjeve dhe mënyrën e dorëzimit të detyrave apo kërkimit të ndihmës nëse hasin në vështirësi. Mësimdhënësi mund të ndjek bashkë me nxënësit video-xhirimet dhe të zhvillojë aktivitete të tjera, kjo sidomos është e rëndësishme për klasat 1-5. Mësimdhënësi po ashtu mund t'u japë informacione kthyesë për detyrat nxënësve.

IAAP

IAAP kanë specifika të veçanta, ku mësimi organizohet përmes mësimit teorik dhe atij praktik, dhe pjesa më e madhe e punës së tyre organizohet në punëtori dhe kabinete (mësimi praktik). Këshillohet që lëndët e praktikës profesionale të mbahen në shkollë, ndërsa lëndët teorike përmes mësimit në distancë. Gjithashtu, gjatë kontaktit fizik mbulohen çështjet më të rëndësishme, të cilat nxënësit mund të kenë pasur problem për ti kuptuar. Kontakti fizik po ashtu shërben për t'u ndihmuar nxënësve që të familjarizohen me metodat virtuale, përdorimin e pajisjeve dhe mënyrën e dorëzimit të detyrave apo kërkimit të ndihmës nëse hasin në vështirësi. Mësimdhënësi po ashtu mund të japë informacione kthyesë për çështjet që ka hasur në detyrat e nxënësve.

Modeli 1. Të identifikohen nga mësimdhënësit pjesët më të rëndësishme të mësimit praktik dhe të futen në funksion të gjitha klasat, punëtoritë dhe të punohet me grupe të vogla të nxënësve (edhe punëtoritë të përdoren si klasë në rast nevojë) dhe për pjesën e praktikës profesionale në ndërmarrje të zvogëlohet numri i nxënësve për grupe.

Modeli 2. Nëse patjetër duhet të organizohet mësim i kombinuar, atëherë të shikohet mundësia e rotacionit të klasave /grupeve me prani në klasë dhe atyre në distancë. Bazuar në mundësitë që ofron kurrikula mësimdhënësit ta organizojnë mësimin me rotacion (një grup një javë në klasë, një javë në shtëpi) dhe javën tjetër të ndërrohen grupet. Natyrisht të mbahet mësim virtual vetëm për ata që nuk janë të pranishëm në shkollë.

Vlerësimi i nxënësve të jetë në vazhdimësi, për ta lehtësuar vlerësimin përfundimtar. Të gjithë mësimdhënësit duhet t'i identifikojnë kompetencat kyçe të nxënësit/es dhe ta krijojnë portfolion e tij/saj.

Realizimi i mësimin për të rritur në IAAP bëhet sipas planifikimit që bëjnë IAAP bazuar në legjisllacionin në fuqi.

UDHËZIME PËR VLERËSIM

Përqëndrimi të jetë tek arritja e rezultateve të përcaktuara në programet lëndore. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzuesin për vlerësim të miratuar nga MASHTI, i cili do të përmbajë edhe informata për vlerësimin e procesit mësimor në distancë.

Udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Fëmijët /nxënësit me nevoja të veçanta duhet të përfshihen në procesin mësimor pavarësisht formës së skenarëve. Në rastet kur klasa shkon në skenarin B, mësimdhënia duhet të përshtatet me kushtet ku ndodhet fëmija dhe me mundësitë/potencialet e tij/saj gjithnjë duke pasur në fokus realizimin e objektivave të përcaktuara me PIA. Në shkollat, ku ka mësues mbështetës apo asistentë, duhet të bëhet plan i mbështetjes duke përfshirë edhe orarin e takimeve/ punës individuale në shkollë apo në distancë. Gjithashtu të gjitha shkollat, edukatorët dhe mësimdhënësit mund ta shfrytëzojnë platformën asimigjithetheper-shires.rks-gov.net, e cila ofron materiale pedagogjike të modifikuara dhe të personalizuar për nxënësit me nevoja të veçanta, por edhe me materiale pedagogjike shtesë për mësimdhënës dhe prindër.

SKENARI C PËR KLASAT 0-12

MËSIMI NË DISTANCË

Skenari C parasheh që mësimi të organizohet plotësisht në distancë. Përveç e-Mësimin, TV, IEAA duhet të përdorin platforma të miratuara nga DKA dhe MASHTI për të mbajtur kontakt të rregullt me nxënësit dhe për t'i dorëzuar detyrat.

Në IAAP mund të organizohet mësimi edhe më tej përmes platformave online. Paraprakisht është e nevojshme të bëhet trajnimi i mësimdhënësve për organizimin dhe planifikimin e procesit mësimor në këtë formë.

Orari

Realizimi i procesit mësimor sipas skenarit C realizohet me orar të reduktuar (30 minuta ora mësimore). Nxënësit dhe prindërit duhet të jenë të njoftuar me kohë për orarin javor, ashtu që të mund të përgatiten.

Mësuesit/Kujdestarët e klasës rekomandohet që, përveç orëve të rregullta, të mbajnë edhe konsultime me nxënës, sipas nevojës.

Zhvillimi i mësimin në distancë në IEAA

Mësimi në distancë mund të përdoret në kombinim me mësimin me prani fizike (Skenari A dhe B) ose si formë e vetme e organizimit të procesit mësimor (Skenari C). Përvoja ka dëshmuar se mësimi në distancë nuk mund të jetë zëvendësim i duhur për mësimin me prani fizike, prandaj kjo formë e mësimin duhet të realizohet vetëm në ato raste kur nuk ka mundësi objektive të zbatohen skenarët me prani të plotë fizike në shkollë.

Mësimi në distancë, në kontekstin kosovar, shoqërohet me vështirësi të caktuara, siç janë:

- Mungesa e pajisjeve teknologjike në shkolla, tek mësimdhënësit dhe/ose nxënësit;
- Qasja e kufizuar në Internet;
- Mungesa e shkathtësive për shfrytëzimin e teknologjisë dhe platformave digjitale;
- Mundësi të kufizuara për mbështetje profesionale dhe mbikëqyrje; etj.

Në rast të organizimit të mësimin në distancë, IEAA duhet t'i shqyrtojnë të gjitha mundësitë që mësimdhënësit t'i shfrytëzojnë hapësirat e IEAA, pasi në këtë mënyrë mund të ofrohet mbështetje dhe të ushtrohet mbikëqyrja e domosdoshme. Në veçanti, kjo vlen për ato IEAA që kanë brez të mjaftueshëm të Internetit dhe rrjet lokal të shtrirë në klasa. Nëse mësimdhënësit ose një numër i mësimdhënësve janë të detyruar të punojnë nga shtëpitë e tyre, udhëheqja e shkollës duhet të vendos një sistem efektiv të evidentimit dhe raportimit të orëve të mbajtura.

Përveç kësaj, duhet evidentuar nxënësit që nuk kanë pajisje teknologjike për të shqyrtuar mundësinë që këto pajisje të sigurohen përmes DKA-së ose donatorëve. Të gjithë nxënësve duhet ofruar udhëzime për shfrytëzimin e teknologjisë për qëllime të mësimin në distancë, në veçanti të platformave online.

MASHTI ka përgatitur video-materialet për nxënësit e klasave 0-9. Këto materiale janë të vendosura në Youtube dhe të organizuara nëpër Playlists sipas klasave (ndërsa brenda klasave gjenden materialet mësimore të lëndëve të ndryshme për klasën përkatëse). Materiale mësimore të veçanta janë përgatitur edhe për fëmijët e moshës parashkollore dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Të gjitha këto janë në dispozicion përmes portalit të MASHTI:

- <https://edukimihershem.rks-gov.net>
- <https://emesimi.rks-gov.net/shq/>

Secili mësimdhënësi duhet të vendos vet se si do të shfrytëzohen këto video-materiale. Një formë e shfrytëzimit mund të jetë që nxënësit të udhëzohen ta ndjekin një njësi mësimore në video, ndërsa gjatë komunikimit me mësimdhënësin përqëndrimi të jetë në përforcim, zgjidhjen e detyrave, zhvillimin e shkathtësive praktike, etj.

Derisa të krijohet një platformë shtetërore për mësimin në distancë, zgjedhja e platformës mësimore mbetet në kompetencë të IEAA, përkatësisht DKA, kjo për faktin se një numër i konsiderueshëm i IEAA dhe DKA-ve tashmë kanë krijuar përvojë në shfrytëzimin e platformave të caktuara. Dy nga platformat mësimore që mund të shfrytëzohen nga IEAA janë:

Pasaporta e të nxënit

Platforma është rezultat i partneritetit në mes të UNICEF, Microsoft dhe University of Cambridge. E filluar me idenë që t'i shërbejë arsimimit të fëmijëve refugjatë, gjatë vitit shkollor 2020/21 është zhvilluar në një platformë të mirëfilltë të mësimin në distancë, e cila ofron mundësi për krijimin e klasave, ofrimin e mësimin në kohë reale, dorëzimin e detyrave të shtëpisë, komunikimin me nxënësit, etj. Përveç kësaj, platforma përmban mbi 14,000 video-regjistrime të orëve mësimore të përgatitura nga MASHTI. Të gjitha informatat për platformën dhe mënyrën e regjistrimit në të mund të gjinden në uebfaqen www.shkollat.org.

MASHTI, në bashkëpunim me UNICEF, është duke ofruar mbështetje për implementimin e platformës në 4 komuna: Gjakovë, Dragash, Gjilan dhe Lipjan. Krahas kësaj, do të ofrohet ndihma teknike për të gjitha IEAA e Republikës së Kosovës që ta shfrytëzojnë këtë platformë për organizimin e mësimin në distancë.

Google Workspace for Education

Platforma e mirënjohur e kompanisë Google mund të shfrytëzohet pa pagesë nga të gjitha institucionet arsimore anekënd botës. Kusht është që IEAA të ketë një domen të regjistruar dhe një uebfaqe. Regjistrimi për shfrytëzimin e platformës bëhet përmes vegëzës:

<https://workspace.google.com/signup/edu/welcome>

Pas regjistrimit, duhet të konfigurohet i tërë sistemi nga një administrator i IEAA. Për personelin dhe nxënësit duhet të hapen e-maila në domenin e IEAA dhe të krijohen klasat. Një Udhëzues për krijimin dhe menaxhimin e klasave është dhënë këtu:

http://www.cpc-ks.org/wp-content/uploads/2020/05/Google-Classroom_Final.pdf

Përveç këtyre platformave të kompanive Microsoft dhe Google, në përdorim janë edhe platforma të tjera, si:

- **eShkollori** - <https://eshkollori.com/index> - qasja mundësohet në bazë të kontratës në mes të komunës dhe kompanisë përkatëse.
- **akademi.al** - <https://www.akademi.al/> - është platformë me qasje falas që shfrytëzohet nga IEAA të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Në raste të caktuara, kur qëllimi është organizimi i mësimin në kohë reale, mund të shfrytëzohen aplikacionet e njohura për video-konferenca siç janë Zoom, Skype, Microsoft Teams, Google Meet, e të ngjashme. Aplikacionet e tilla janë treguar të dobishme në ato situata kur mësimi në distancë zhvillohet në kombinim me mësimin me prani fizike (Skenari A dhe B), si dhe në situatat kur aplikohet Skenari C për një kohë të shkurtër prej disa ditësh.

Niveli i arsimit të mesëm të lartë

Në rast të skenarit për mësim në distancë në IAAP, mësimdhënësit duhet të jenë në klasë/kabinete dhe ta formojnë klasën e tyre virtuale/online me të gjitha klasat. Mësimdhënësit duhet t'i përdorin edhe pajisjet mësimore që i kanë në dispozicion në klasë dhe punëtori për të demonstruar kuptimin sa më të mirë të njësisë mësimore. Ora të jetë e plotë.

Mësimdhënësit duhet të punojnë për pjesën e mësimin në distancë përmes platformave si Microsoft Teams, ose të ngjashme, të cilat mundësojnë komunikimin video audio, interaktivitet, testim, vlerësim, monitorim dhe raportim.

Në IAAP gjatë kohës së pandemisë është përdorur MS Teams, Google, Zoom, si dhe Labster për shkenca aplikative dhe Autodesk Fusion 365 për punë laboratorike dhe praktike përmes realitetit online.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi orientohet drejt platformave digjitale, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenien e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Përqëndrimi duhet të jetë tek arritja e rezultateve të përcaktuara në programet lëndore. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzuesin për vlerësim të miratuar nga MASHTI, i cili do të përmbajë edhe informata për vlerësimin e procesit mësimor në distancë.

Udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta në shumicën e rasteve nuk mund t'i përcjellin mësimet që ofrohen përmes platformave pa ndihmën e prindit/kujdestarit ligjor, andaj mësimdhënësit duhet të bëjnë përpjekje që në të gjitha rastet, ku ka mundësi, fëmija/nxënësi të jetë i përfshirë me gjithë klasën. Nëse për shkak të aftësisë së kufizuar nxënësi nuk mund të marrë pjesë bashkë me klasën, atëherë duhet të ofrohet përkrahje individuale (përmbajtje/ aktivitete të modifikuara për aplikim në kushte shtëpie). Kjo bëhet përmes takimeve individuale me nxënësin apo bashkëpunimit të ngushtë me prindërit/ kujdestarët e fëmijeve të cilëve u jepen udhëzime paraprake.

Në rastet kur IEAA ka mësues mbështetës dhe asistentë, atëherë mësimdhënësit bashkëpunojnë dhe koordinohen së bashku për t'i mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta. Në të gjitha rastet mësuesit klasorë dhe mësimdhënësit lëndorë janë përgjegjës për realizimin e përmbajtjes së paraparë me programet lëndore apo PIA.

Shih udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta.²¹

²¹ <https://masht.rks.gov.net/uploads/2020/08/udhezues-per-perkrahen-e-nxenesve-me-nevoja-te-vecanta-gjate-mesimit-ne-distancë-dhe-online-2020-2021-1.docx>

6. ZBATIMI I KURRIKULËS DHE UDHËZIMET METODOLOGJIKE

Mësimdhënësit dhe udhëheqja e IEAA duhet t'i kenë parasysh qëllimet e arsimit parauniversitar të Kosovës, të përcaktuara si:

- kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm;
- aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.

Objektivat e arsimit parauniversitar do të vazhdojnë të jenë të drejtuara edhe në kushte të emergjencës kah realizimi i kompetencave kryesore në mënyrë të barabartë, pa anashkaluar ndonjërin prej tyre. Arritja e këtyre kompetencave dhe rezultateve të të nxëniet të fushës (RNF) dhe të lëndëve të caktuara (RNL) realizohet sipas një plani të mirëorganizuar mësimor dhe me qasjen e mësimin të integruar.

Njësitë mësimore, detyrat, projektet dhe instrumentet e vlerësimit duhet të planifikohen dhe të realizohen mirë si kontribut i drejtpërdrejtë në zhvillimin apo arritjen e tyre.

6 kompetencat kryesore të parapara që të zhvillohen në arsimin parauniversitar në Kosovë

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit (kritik dhe kreativ)
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Reduktimi i përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxënit të lëndëve (RNL) dhe (RNF)

Në vitin shkollor 2021/22, reduktimet nga mësimdhënësit nuk duhet të bëhen në mënyrë të njëanshme duke favorizuar një fushë kurrikulare në raport me tjetrën, apo lëndë të caktuara, e as në dëm të lëndëve zgjedhore ndaj atyre të obligueshme. Në skenarët e organizimit të mësimit në kushte pandemie COVID-19 (Rikthimi, A, B, dhe C), mësimdhënësit obligohen t'i planifikojnë dhe t'i zbatojnë programet mësimore-lëndore sipas klasave dhe të ndjekin filozofinë e dokumenteve kurrikulare (KKK dhe kurrikulave bërthamë).

Mësimi Plotësues

Mësimi Plotësues bazohet në nevojat e nxënësve dhe komuniteteve. Fokusi kryesor duhet të jetë te të nxënit e nxënësit/nxënëses. Mësimi plotësues përfshin nxënësit të cilët nuk kanë ndjekur apo nuk kanë arritur rezultatet e planifikuara në mësim.

Mësimi plotësues **realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë vitit shkollor** dhe duhet të jetë në përputhje me kërkesat kurrikulare.

7. MONITORIMI DHE INSPEKTIMI

Gjatë vitit shkollor 2021/2022, procesi mësimor në të gjitha IEAA do të monitorohet dhe mbikëqyrret nga Inspektorati i Arsimit përmes inspektimit të përgjithshëm, tematik, emergjent dhe riinspektimit. Mënyra e inspektimit do t'u përshtatet kushteve në kohë pandemie dhe mësimi nga distanca. Do të përgatiten raporte dhe procesverbale lidhur me konstatimin e gjendjes faktike.

Gjatë kësaj periudhe, Inspektorati i Arsimit ka këto prioritetet si në vijim:

- Të mbikëqyrë respektimin e protokollit COVID-19 nga IEAA;
- T'i monitorojë dhe t'i mbikëqyrë IEAA në zbatimin e skenarëve;
- Të mbikëqyrë respektimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Të mledhë dhe t'i raportojë në baza ditore të dhënat për rastet e konfirmuara me COVID-19 të nxënësve/mësimdhënësve.

| Afati kohor | Objektiva | Aktivitetet e Inspektoratit | Burimet e nevojshme | Veprimet |
|---------------------------|--|--|--|--|
| shtator, 2021-gusht 2022 | Koordinimi me Task Forcën | <ul style="list-style-type: none"> • Caktimi i anëtarit në Task Forcë. • Pjesëmarrja në mbledhjet e Task Forcës. • Përpilimi i raporteve dhe procesverbaleve. | <ul style="list-style-type: none"> • Platformat; • Skenarët; • Protokollit COVID-19 | |
| shtator, 2021-gusht, 2022 | Zbatimi i skenarëve nga IEAA | <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e planit të veprimit për mbikëqyrjen dhe monitorimin e IEAA. | <ul style="list-style-type: none"> • Protokollit COVID-19; • Lista e kontrollit. | <ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e kapaciteteve të inspektorëve të arsimit- MASHTI për masat COVID-19; • Bashkëveprimi dhe bashkëpunimi me inspektorët sanitarë për respektimin e masave, sipas protokollit COVID-19; • Angazhimi i inspektorëve shtesë për zbatim të masave. |
| shtator, 2021 gusht, 2022 | Monitorimi i trajnimeve të mësimdhënësve | <ul style="list-style-type: none"> • Të caktohen inspektorët për monitorim; • Të përgatitet metodologjia; • Të bëhet raporti mbi monitorimin. | <ul style="list-style-type: none"> • Programet e Trajnimeve të miratuara nga MASHTI. | Sipas orarit |

8. TRAJNIMI I MËSIMDHËNËSVE, PERSONELIT MENAXHERIAL DHE PËRKRAHËS TË IEAA DHE AKTERËVE TË TJERË

Trajnimet obliguese kualifikuese për mësimdhënës

MASHTI-DIVIZIONI I TRAJNIMEVE ka definuar listën me trajnimet bazë të domosdoshme për të zbatuar skenarët e propozuar në këtë dokument. Gjithashtu, duhet të definojë, në baza pedagogjike, kërkesat minimale për përdorim të teknologjive digjitale. Në mënyrë që proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies të organizohen me mbështetje digjitale, ekziston nevoja për një ofertë kualifikimi, në të cilin do të kenë qasje mësimdhënësit sipas kërkesave dhe nivelit të kompetencave të tyre.

Veprimet në lidhje me trajnimet obliguese për mësimin në distancë janë:

- Bashkëveprimi me DKA lidhur me kërkesat dhe nevojat e trajnimeve për mësimdhënës;
- Trajnimi i mësimdhënësve për përdorimin e platformës nga ofruesi i platformës ose trupa profesionale;
- Trajnimi i mësimdhënësve për metodologji të mësimin në distancë si dhe i punës eksperimentale;
- Ofrimi i trajnimit të mësimdhënësve për mjete të TIK-ut;
- Trajnime për metodat e mësimdhënies online dhe të kombinuar.

Përveç mësimdhënësve, të gjithë akterët ballafaqohen me mësimin në distancë, prandaj programi i trajnimeve duhet të përfshijë edhe trajnime të tjera që rrisin produktivitetin, komunikimin dhe bashkëveprimin në kohë pandemie.

MASHTI, në bashkëpunim me partneret zhvillimorë, ofron trajnime varësisht prej kërkesave, nevojave që dalin nga situata epidemiologjike përgjatë vitit shkollor. Ndërsa, për programet e trajnimit për vitin shkollor 2021/22, të interesuarit mund t'i referohen katalogut.

- Katalogu i programeve të aprovuara për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe udhëheqësve të arsimit i: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2021/06/katalogu-web.pdf>

9

ANEKSET





PËRGJEGJËSITË E TRI TASK FORCEVE NË NIVEL TË MASHTI, DKA dhe IEAA

për organizimin efikas të procesit edukativ-mësimor me prani fizike në kushte të pandemisë COVID-19

TASK FORCA NË NIVEL TË MASHTI

- Mban mbledhje të rregullta për vlerësim të situatës (së paku një herë ne muaj) dhe dhënien e rekomandimeve për Ministren për veprime të mëtutjeshme;
- Harton raporte të rregullta për Ministren;
- Monitoron zbatimin e skenarëve në vitin e ri shkollor 2021/22;
- Monitoron zbatimin e masave në nivel të IEAA të përcaktuara në protokollin e COVID-19;
- Mban takime të rregullta me të gjitha palët e tjera në kuadër të përgjegjësi të tyre.

TASK FORCA NË NIVEL TË DKA

- Mban mbledhje të rregullta për vlerësim të situatës në nivel të komunës (së paku një herë në muaj);
- Harton raporte të rregullta për Task Forcën në MASHTI;
- Monitoron zbatimin e skenarëve në nivel të komunës;
- Analizon raportet nga secila Task Forcë në IEAA;
- Monitoron zbatimin e masave në nivel të IEAA të përcaktuara në protokollin e COVID-19;
- Përpilon plan të zëvendësimit të pjesëtarëve të personelit që mungojnë në bashkëveprim me Task Forcën në IEAA.

TASK FORCA NË NIVEL TË IEAA

- Përpilon plan të punës (ku përfshihen: mbledhjet e rregullta, orari, formati i takimeve, mënyra e vendimmarrjes);
- Përpilon plan të veprimit dhe vendos mbi aplikimin e skenarëve varësisht nga gjendja në IEAA/klasë;
- Monitoron zbatimin e skenarëve në IEAA/klasa;
- Verifikon skenarët me nivelin e rrezikshmërisë në komunë dhe kushtet e IEAA në bashkëveprim me Task Forcën në DKA;
- Përcakton masat përkrahëse për edukatorët/mësimdhënësit, fëmijët/nxënësit, prindërit dhe personelit tjetër të IEAA;
- Raporton tek Task Forca e DKA-së (mbi mungesat e nxënësve dhe punonjësve përkatës; situatën në IEAA; mungesën/nevojën për materiale higjienike, edukative etj.);
- Evidenton nevojat e mësimdhënësve/edukatoreve për trajnim;
- Përpilon plan të zëvendësimit të pjesëtarëve të personelit që mungojnë;
- Organizon klasat varësisht nga numri i nxënësve dhe
- hapësirës që kanë në dispozicion dhe në bashkëveprim me TF në DKA.





DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PJESËMARRËSVE NË PROCESIN EDUKATIV-ARSIMOR NË NIVEL TË MASHTI, DKA dhe IEAA për organizimin efikas të procesit edukativ-mësues me prani fizike në kushte të pandemisë COVID-19

TASK FORCA NË NIVEL TË MASHTI

- Mban mbledhje të rregullta për vlerësim të situatës (së paku një herë në muaj) dhe dhënien e rekomandimeve për Ministrën për veprime të mëtejshme;
- Harton raporte të rregullta për Ministrën;
- Monitoron zbatimin e skenarëve në vitin e ri shkollor 2021/22;
- Monitoron zbatimin e masave në nivel të IEAA të përcaktuara në protokollin e COVID-19;
- Mban takime të rregullta me të gjitha palët e tjera në kuadër të përgjegjësisë të tyre.

TASK FORCA NË NIVEL TË DKA

- Mban mbledhje të rregullta për vlerësim të situatës në nivel të komunës (së paku një herë në muaj);
- Harton raporte të rregullta për Task Forcën në MASHTI;
- Monitoron zbatimin e skenarëve në nivel të komunës;
- Analizon raportet nga secila Task Forcë në IEAA;
- Monitoron zbatimin e masave në nivel të IEAA të përcaktuara në protokollin e COVID-19;
- Përpilon plan të zëvendësimit të pjesëtarëve të personelit që mungojnë në bashkëveprim me Task Forcën në IEAA.

TASK FORCA NË NIVEL TË IEAA

- Përpilon plan të punës (ku përfshihen: mbledhjet e rregullta, orari, formati i takimeve, mënyra e vendimarrjes);
- Përpilon plan të veprimit dhe vendos mbi aplikimin e skenarëve varësisht nga gjendja në IEAA/klasë;
- Monitoron zbatimin e skenarëve në IEAA/klasa;
- Verifikon skenarët me nivelin e rrezikshmërisë në komunë dhe kushtet e IEAA në bashkëveprim me Task Forcën në DKA;
- Përcakton masat përkrahëse për edukatorët/mësimdhënësit, fëmijët/nxënësit, prindërit dhe personelit tjetër të IEAA;
- Raporton tek Task Forca e DKA-së (mbi mungesat e nxënësve dhe punonjësve përkatës; situatën në IEAA; mungesën/nevojën për materiale higjienike, edukative etj.);
- Evidenton nevojat e mësimdhënësve/edukatoreve për trajnim;
- Përpilon plan të zëvendësimit të pjesëtarëve të personelit që mungojnë;
- Organizon klasat varësisht nga numri i nxënësve dhe hapësirës që kanë në dispozicion dhe në bashkëveprim me TF në DKA.

KËSHILLI DREJTUES (KD) I IEAA

- Takohet sipas funksionit të përcaktuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar;
- Mban Task Forcën në nivel të IEAA operacionale;
- Shqyrton raportet mujore të IEAA.

MENAXHMENTI I IEAA

- Në koordinim me TF në IEAA, bën planifikimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor sipas skenarëve;
- Koordinon organizimin e procesit mësimor sipas skenarëve dhe i raporton rregullisht DKA-së;
- Siguron respektimin e masave sipas protokollit COVID-19 dhe vaksinimin e personelit;
- Evidenton fëmijët/nxënësit, që nuk kanë pajisje, të ndjekin edukimin dhe siguron që të ndërmerren masa për ta mundësuar realizimin e përmbajtjes edukative sipas skenarëve;
- Evidenton edukatorët/mësimdhënësit që kanë nevojë për përkrahje shtesë për mësimin në distancë;
- Informon edukatorët/mësimdhënësit/aktivet e lëndëve dhe të klasave për udhëzuesin;
- Cakton një koordinator për teknologji dhe platforma;
- Bashkëpunon me prindërit/kujdestarët ligjorë, për t'u mundësuar fëmijëve një kalim të natyrshëm nga ambienti i shtëpisë në IEAA;
- Informon prindërit/kujdestarët ligjorë për masat që zbaton IEAA, planin e veprimit dhe kërkon bashkëpunim për raportim të secilit rast të COVID-19 që ndodh në familje;
- Evidenton personelin dhe fëmijët që janë në rrezik të lartë për shkak të moshës ose gjendjes shëndetësore;
- Ndërmerr masa për zëvendësimin e personelit sipas nevojës.

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

- Mban Task Forcën e MASHTI operacionale;
- Formulon dhe miraton skenarët sipas nivelit të rrezikshmërisë në bashkëpunim me IKSHPK;
- Mbështet dhe komunikon në mënyrë të rregullt me DKA-të për zbatimin e skenarëve;
- Bashkëvepron me MSH, IKSHPK, DKA-të, IEAA dhe partnerët strategjikë për vetëdijësimin e komunitetit shkollor e të prindërve mbi rëndësinë e vaksinimit dhe respektimit të plotë të masave;
- Miraton tekste dhe materialet mësimore dhe pajis shkollat me tekste shkollore fizike dhe digjitale;
- Bashkëvepron me DKA për plotësimin e kushteve për organizimin e procesit edukativ-arsimor;
- Mban takime të rregullta me të gjithë drejtorët e DKA-ve;
- Inspekton zbatimin e procesit edukativ-arsimor sipas skenarëve;
- Angazhon ekspertizë për çështje të veçanta apo hulumtime profesionale;
- Miraton Kalendarin e vitit shkollor 2021/2022;
- Ofron mbështetje për mësimdhënien dhe vlerësimin e fëmijëve/nxënësve për të arritur rezultatet e të nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave të Kurrikulës.

DREJTORITË KOMUNALE TË ARSIMIT (DKA-të)

- Mbajnë Task Forcat në nivel DKA operacionale;
- Koordinojnë dhe menaxhojnë IEAA dhe personelin arsimor në nivel të komunave dhe ndihmojnë në realizimin e mësimit sipas skenarëve;
- Vendosin format e vendimarrjes, raportimit dhe vlerësimit të performancës së personelit përmes komunikimit fizik sipas protokollit COVID-19 apo komunikimit nëpërmjet formave të aprovuara virtuale, kur paraqitet kjo nevojë;
- Realizojnë aktivitete vetëdijësimi mbi rëndësinë e vaksinimit të komunitetit shkollor e prindërve për mbarëvajtjen e procesit mësimor si dhe shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve e të gjithë të tjerëve;
- Organizojnë trajnime për mësimdhënësit në nivel të komunës në bashkëpunim me MASHTI dhe donatorët;
- Organizojnë takime individuale me drejtorët të IEAA;
- Raportojnë në baza javore në MASHTI për ecurinë dhe sfidat e organizimit të procesit mësimor si dhe për nivelin e vaksinimit të personelit shkollor në nivel të komunës;
- Komunikojnë në mënyrë efektive dhe të sigurt me Këshillin e Prindërve;
- Planifikojnë sigurimin dhe shpërndarjen e materialeve shkollore të nxënësit;
- Evidentojnë fëmijët/nxënësit dhe edukatorët/mësimdhënësit që kanë nevojë për pajisje si laptop dhe tablete;
- Sigurojnë pajisje të nevojshme teknologjike për mësimin në distancë (me ndihmën e MASHTI ose të donatorëve);
- Ofron trajnime për ngritje të kapaciteteve për edukatorët/mësimdhënësit;
- Sigurojnë kushte për realizimin e procesit mësimor sipas skenarëve të përcaktuar në këtë udhëzues (Internet të qëndrueshëm; personeli mbështetës teknik si pikë kontakti për IEAA për çështje të digjitalizimit).

INSTITUCIONET EDUKATIVE ARSIMORE DHE AFTËSUESE (IEAA)

- Mbajnë Task Forcat në nivel të IEAA operacionale;
- Në ditën e parë të mësimit, informojnë nxënësit/fëmijët dhe personelin arsimor për rregullat dhe masat për parandalim të COVID-19, sipas udhëzuesve të IKSHPK;
- Ofron informata mbi pandeminë dhe masat parandaluese që duhet të merren nga nxënësit/fëmijët dhe personeli arsimor varësisht nga ambienti/rrethanat ku gjenden (mënyrën e sjelljes në rastet kur janë vetëm, në grup, gjatë aktiviteteve, etj.);
- Sigurohen që materialet edukative-informuese janë të ekspozuara në vende të dukshme për nxënësit në të gjitha hapësirat shkollore apo edhe online;
- Mbajnë përgjegjësinë kryesore për realizimin e procesit edukativ-arsimor sipas skenarëve të miratuar nga MASHTI dhe rekomandimet e IKSHPK;
- Ofron mësimdhënie dhe mësimnxënje cilësore për të gjithë fëmijët/nxënësit pavarësisht rrethanave pandemike;
- Realizojnë aktivitete vetëdijësimi mbi rëndësinë e vaksinimit të komunitetit shkollor e prindërve për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe shëndetin e mirëqenien e fëmijëve e të gjithë të tjerëve;
- Me mbështetje të TF në IEAA, organizojnë klasat dhe hapësirat sipas skenarëve;
- Ofron shërbime mbështetëse të Teknologjisë Informative përmes koordinatort;
- Hartojnë plan për të ushqyerit e fëmijëve në grupe të vogla, duke respektuar distancën fizike.

MËSUESIT KLASORË DHE EDUKATORËT PARAFILLORË (KLASAT 0-5)

- Realizojnë procesin mësimor sipas skenarëve të detajuar në këtë udhëzues;
- Kujdesen për respektimin e masave sipas protokollit COVID-19;
- Informojnë prindërit/kujdestarët ligjorë të fëmijëve për formën e organizimit të procesit mësimor përgjatë vitit shkollor;
- Në raste të mësimit të kombinuar, kujdesen për angazhimin dhe kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe pjesëmarrjen në mësim të të gjithë nxënësve.

KRYETARËT E AKTIVEVE

- Komunikojnë me anëtarët e aktivitetit me qëllim të përcjelljes së detyrave nga udhëheqja (menaxhmenti) dhe Këshilli i IEAA për respektim të masave dhe vaksinim;
- Bashkëpunojnë në planifikim të procesit mësimor dhe ofrimin të mbështetjes për mësimdhënësit dhe të tjerët;
- Këshillojnë mësimdhënësit, u ndihmojnë për tejkalimin e problemeve dhe përcjellin realizimin e kurrikulës bërthamë dhe njësive mësimore;
- Mbajnë komunikim të vazhdueshëm me kujdestarët e klasave dhe me mësimdhënësit për realizimin e procesit mësimor.

MËSUESIT LËNDORË DHE KUJDESTARËT E KLASAVE (PËR KLASAT 6-12)

MËSUESIT LËNDORË:

- Realizojnë procesin mësimor sipas skenarëve të detajuar në këtë udhëzues;
- Kujdesen për respektimin e masave sipas protokollit COVID-19;
- Informojnë prindërit/kujdestarët ligjorë të fëmijëve për formën e organizimit të procesit mësimor përgjatë vitit shkollor;
- Në raste të mësimit të kombinuar, kujdesen për angazhimin dhe kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe pjesëmarrjes në mësim të të gjithë nxënësve;
- Organizojnë grupe virtuale me nxënësit e paraleles së vet në shkollë ose nga shtëpia, në rastet kur paraqitet kjo nevojë, (p.sh., klasa nuk ka hapësirë të mjaftueshme sipas protokollit COVID-19, ndërsa IEAA ka hapësirë të lirë dhe kapacitete teknike për mësim në distancë);

KUJDESTARËT E KLASAVE:




- Komunikojnë me mësimdhënësit e angazhuar në punë me klasën ku kujdestarojnë;
- Përcaktojnë orarin e mësimit në distancë dhe komunikojnë me prindërit për angazhimin e rregullt të nxënësve;
- Mbajnë mbledhje të prindërve, fizike ose virtuale, sipas kushteve;
- Përcaktojnë në ditë të konsultimeve me klasat e veta;
- Organizojnë mbështetjen e ndonjë grupi të nxënësve me prani të herëpashershme në shkollë, sipas nevojës dhe skenarëve në fuqi.



MATERIALET INFORMUESE DHE SHENJËZUESE PËR MASAT MBROJTËSE NGA COVID-19

Në linkun e mëposhtëm mund t'i shkarkoni materialet e gatshme për printim.

<https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>





REPUBLIKA E KOSOVËS
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**